

Perspektivat e Komunitetit në Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Maqedoni

Filip Stojkovski & Natasia Kalajdziovski

Country Case
Study 1

Për raportin

Ky rast studimi është përgatitur për shtetin e Maqedonisë së bashku me tre raste tjera, përfshirë Shqipërinë, Bosna dhe Hercegovinën dhe Kosovën, në kuadër të projektit kërkimorë participativ, me temën “Mundësitë për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm në Ballkanin Perëndimorë.”

Së bashku me katër partnerë lokal, ne hulumtojmë pse disa komunitete janë më shumë të prekura nga individë të frymëzuar nga dhe / ose për t’ju bashkuar Shtetit Islamik ose grupeve të tjera të ngjashme ekstremiste, ndërsa disa komunitete tjera mund të shfaqin qëndrueshmëri më të madhe ndaj të njëjtit fenomen. Bazuar në gjetjet e hulumtimit, partnerët e projektit do të zhvillojnë iniciativa për shtrirjen e politikave dhe dialogut lokal, në bashkëpunim me aktorët lokalë dhe komunitetet e prekura, me qëllim të hulumtimit dhe zhvillimit të strategjive për parandalimin e radikalizimit të dhunshëm në Ballkanin Perëndimor.

Për autorët

Filip Stojkovski është një profesionist i çështjeve ndërkombëtare i specializuar në Hulumtim dhe Politika publike në Fushën e mbrojtjes dhe sigurisë. Ekspertizat e tij përfshijnë fushat si: kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, marrëdhëniet civile-ushtarake dhe integrimin Euro-Atlantik, me fokus të veçantë për Ballkanin Perëndimorë. Ai ka bërë hulumtime gjithëpërfshirëse mbi nxitësit dhe faktorët e radikalizimit në Maqedoni. Ai është magjistër i shkencës në Çështjet Publike dhe Ndërkombëtare në Universitetin e Pitsburgut në drejtimin: Studime të Sigurisë dhe Inteligjencës.

Natasia Kalajxhiovski është PhD kandidate në Universitetin Middlesex. Ajo momentalisht është në Universitetin e Drejtësisë, ku u shpërblye me burse të plotë studimesh hulumtuese për të mbaruar studimet e saja. Ajo mban titullin e magjistres së arteve të klasit të parë nga Departamenti i Studimeve të Luftës, në Kolehjin Kings të Londrës, dhe titullin Baçelor i Arteve në Universitetin e Torontos. Në përgjithësi, hulumtimi i saj shqyrton sjelljen morale në praktikën e inteligjencës dhe kundër – terrorizmit në kontekstin e sigurisë nacionale, që ka të bëjë me shtete liberale demokratike.

Jashtë akademisë, Natasia jep kontribut të vazhdueshëm me publikime në fushën e kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm, dhe gjithashtu ajo konsultohet me organizata të ndryshme si një ekspert lëndësh në fushën e saj të ekspertizës kërkimore. Së fundmi, puna e saj mund të haset në Gerogetown Security Studies Review dhe në British Councils Extremism Research Forum. Ajo gjithashtu është hulumtuese e re në Canadian Network for Research on Terrorism, Security and Society (TSAS).

Falënderim

Projekti dhe raporti u mbështet nga Ministria e Punëve të Jashtme të Gjermanisë.



Auswärtiges Amt

Layout & Desktop publishing: Astrid Fischer

© 2018 Berghof Foundation Operations GmbH. All rights reserved.

To cite this Paper: Filip Stojkovski & Natasia Kalajdziovski (2018): Community Perspectives on the Prevention of Violent Extremism in Macedonia. Country Case Study 1. Berlin/Skopje: Berghof Foundation and Democracy Lab.

Available also online: <<http://image.berghof-foundation.org/fileadmin/redaktion/Publications/Papers/>. First launch : 11/09/2018

Shënim

Pikëpamjet e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet dhe mendimet e Fondacionit Berghof ose partnerëve të tij.

Berghof Foundation

Altensteinstraße 48a
14195 Berlin
Germany
www.berghof-foundation.org
info@berghof-foundation.org

Përmbledhja

Përmbledhja Ekzekutive	1
1 Hyrje	2
1.1 Arsyetim për studimin	2
1.2 Historia e Shtetit	2
1.3 Ekstremizmi i dhunshëm në Maqedoni - Një vështrim i përgjithshëm	4
1.4 Qasjet aktuale ndaj programeve të P/CVE	4
2 Metodologjia	6
2.1 Konceptet dhe terminologjia	7
2.2 Projektimi i punës në teren	7
2.3 Korniza Analitike	8
2.4 Kufizimet në kërkime	9
3 Eksplorimi i gjetjeve	9
3.1 Qasjet Analitike	9
3.2 Faktorët e vulnerabilitetit	10
3.2.1 Mjediset e përshtatshme dhe Strukturat Mbështetëse	10
3.2.2 Ideologjitë Ekstreme, Rrjetet dhe Lidhjet Ndër-personale	16
3.2.3 Pakënaqësitë Kolektive dhe Personale	17
3.3 Faktorët e qendrueshmërisë (Reziliencës)	20
3.3.1 Multikulturalizmi	20
3.3.2 Angazhimi në Komunitet dhe Ndërgjegjësimi Shoqëror	21
3.3.3 Cilësia e Edukimit Fetar	22
3.3.4 Bashkëpunimi dhe Angazhimi Institucional	23
3.4 Përfundimi	24
4 Analiza e Gjetjeve	24
4.1 Krijimi i mjedisit dhe strukturave mbështetëse	25
4.2 Ideologjitë ekstreme, rrjetet dhe lidhjet interpersonale	27
4.3 Pakënaqësitë kolektive dhe personale	28
5 Konkluzioni	29
Referenca	31
Intervista dhe Fokus Grupe	33

Përmbledhja Ekzekutive

Gjithnjë e më shumë, strategjitë qeveritare për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm P/CVE konsiderohen si një plotësim i domosdoshëm për strategjitë më të gjera kundër terrorizmit. Një përfshirje e tillë është një njohje se një qasje e pastër e “sekuritizimit” nuk është tërësisht efektive dhe se një strategji që përfshin një “qasje të butë” për të luftuar terrorizmin duhet të kërkojë të adresojë edhe faktorët socialë. Megjithatë, brenda rajonit të Ballkanit Perëndimor – dhe veçanërisht në kontekstin e Maqedonisë – strategjitë për të luftuar terrorizmin kanë qenë të ngadalta në miratimin e qasjeve të Parandalimit/Kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm (më tej në tekst P/CVE).

Si e tillë, ekzistojnë boshllëqe në literaturën mbi P/CVE në Maqedoni. Hulumtimet nën siglën e P/CVE janë përqendruar tradicionalisht tek faktorët që çojnë në ekstremizëm të dhunshëm; ndërkohë që ky lloj hulumtimi ka qenë kritik, pak është bërë për të gërmuar më thellë në narrativet shoqërore. Duke pasur parasysh “qasjen e butë” të qenësishme brenda kornizës më të gjerë të P/CVE, një mungesë e tillë në hulumtim është problematik nga pikëpamja e krijimit të politikave. Prandaj, ky raport paraqet një studim cilësor mbi atë se si dinamika e nivelit të komunitetit kontribuon në rastet e ekstremizmit të dhunshëm dhe kërkon të sigurojë të dhëna relevante për të ndihmuar krijuesit e politikave të fuqizojnë komunitetet në mënyrë që ato të bëhen mekanizma të ndryshimeve shoqërore në luftën kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Për këtë qëllim, raporti hulumton tre komuna që ndryshojnë në nivelin e ndikimit të tyre në Republikën e Maqedonisë – Çair, Gostivar dhe Strugë – të cilat janë konsideruar me ndikim të lartë, ndikim të moderuar, relativisht të ndikuara nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm. Puna në terren u krye për të mbledhur të dhëna përmes përdorimit të intervistave gjysmë të strukturuar dhe konsultimit të grupeve të fokusit. Për më tepër, ky raport përdor një version të përshtatur të kuadrit të krijuar nga Mohammed Hafez dhe Creighton Mullins (2015) për të prezantuar të dhënat dhe për të organizuar analizën e raportit.

Duke përdorur të dhënat e mbledhura gjatë punës në terren, raporti synon të përcaktojë se çfarë e bën çdo komunë të lartpërmendur më shumë ose më pak të prekur nga radikalizmi i dhunshëm. Në fund, gjetjet flasin për realitetin se radikalizimi drejt ekstremizmit të dhunshëm nuk është një proces linear; përkundrazi, përfshinë një sërë faktorësh që bashkohen për të krijuar një mjedis të përshtatshëm që mundëson në përhapjen e ekstremizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Të bazuar në gjetjet e raportit të këtij hulumtimi, ne japim tre rekomandime për të përmirësuar qasjet preventive kundrejt ekstremizmit të dhunshëm:

- 1) Strategjia e Maqedonisë për P/CVE duhet të ndryshoj qasjen nga një strategji shtetërore e bazuar në principin nga lartë-poshtë, në një strategji më të gjithëpërfshirëse (holistike) dhe që inkuadron, fuqizon dhe që edukon aktorët institucional lokal në këto përpjekje.
- 2) Diskursi i parandalimit dhe kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm duhet të evoluoj që të përfshijë gjithashtu edhe ekstremizmin etno-nacionalist dhe të ekstremit të djathtë që janë në rritje në Maqedoni.
- 3) Hulumtime të mëtejshme dhe më të thella duhet të bëhen për të parë ndërlidhjen mes etnisë, perceptimit të pushtetit dhe ndarjeve shoqërore për të qartësuar se si këto variabla risin vunerabilitetin brenda një komune. Gjetjet e këtyre hulumtimeve duhet të jenë informative për programet e ardhshme për P/CVE.

*Autorët duan të falënderojnë hulumtuesit e rinj Artina Zeqiri, Rona Kamberi dhe Elton Jashari për kontributin e tyre

1 Hyrje

1.1 Arsyetim për studimin

Brenda narrativit global për zhvillimin e masave efektive për të luftuar terrorizmin, strategjitë në lidhje me parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm P/CVE gjithnjë e më shumë janë miratuar nga qeveritë, përkrah dhe në plotësim të masave kundër terrorizmit. Aty ku ka pasur vetëm një përpjekje për të parandaluar një akt terrori para se të ndodhte, shpesh i shprehur përmes objektivit të “sekuritizacionit”, P/CVE tani është zhvilluar si një “qasje e butë” për të luftuar terrorizmin, i cili “nënvizon faktin se ekstremizmi i dhunshëm është po aq, nëse jo më shumë se një çështje sociale, sa ç’është një çështje sigurie” (Aly 2015, 1). Siç thotë Anne Aly:

Qasjet që përqendrohen vetëm në sigurinë publike, sigurinë kombëtare, zbatimin e ligjit dhe masat ndëshkimore, jo vetëm që e lënë pas dore këtë fakt, ato po ashtu shfuqizojnë komunitetet dhe organizatat e shoqërisë civile për t’u bërë mekanizma të ndryshimeve shoqërore (2015, 1).

Si e tillë, një qasje e veçuar dhe e “sekuritizuar” për të luftuar terrorizmin është problematike, nuk adreson apo përfshin të gjitha palët e interesuara në reduktimin e ekstremizmit, dhe nuk bën shumë për të siguruar një përgjigje gjithëpërfshirëse të politikave për të trajtuar atë që gjithnjë e më shumë shihet si çështje komplekse shoqërore.

Në kontekstin e Ballkanit Perëndimor dhe veçanërisht në Republikën e Maqedonisë, adoptimi i iniciativave P/CVE, duke përfshirë zhvillimin e planeve të veprimit të P/CVE nga qeveritë e Ballkanit Perëndimor së bashku me strategjitë kundër terrorizmit, kanë qenë të ngadalshme në zhvillimin dhe zbatimin e tyre. Përderisa disa hulumtime janë ndërmarrë në këtë fushë, dhe në veçanti nga think-tanket rajonale, qeveritë e njëpasnjëshme të Maqedonisë kanë priorizuar qasjen e lartpërmendur të “sekuritizimit” në strategjitë e tyre. Për më tepër, pjesa më e madhe e hulumtimeve të ndërmarra është përqendruar vetëm tek faktorët individual që kontribuojnë në rritjen e ekstremizmit të dhunshëm (për shembull, Kadri dhe Shabani 2018, Selimi dhe Stojkovski 2016). Për më tepër, krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor si Kosova, Shqipëria dhe Bosnja dhe Hercegovina në veçanti, brenda kontekstit të Maqedonisë janë kryer më pak hulumtime. Për këtë shkak edhe ekzistojnë boshllëqe në literaturë.

Prandaj, qëllimi i këtij materiali hulumtues është të zgjerohet në thelbin aktual të hulumtimit dhe të trajtojë fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm nga një perspektivë e pashpjeguar deri tani – ajo synon të hetojë, të kuptojë dhe të kontekstualizojë dinamikat në nivelet e komunitetit në komunat brenda Republikës së Maqedonisë që konsiderohen të jenë shumë të prekura, të prekura në mënyrë të moderuar dhe të paprekura nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm. Qëllimi i këtij raporti është që të sigurojë politikëbërësit me të dhëna, udhëzime dhe kontekst të mëtejshëm në zhvillimin e një strategjie gjithëpërfshirëse për parandalimin dhe luftimin e ekstremizmit të dhunshëm. Për më tepër, fushëveprimi i hulumtimit nuk është i përgjithshëm; përkundrazi, ai gërmon në specifikat e tri komunave në Maqedoni – Çair, Gostivar dhe Strugë – në përpjekje për të përcaktuar se çfarë e bën një komunë pak ose shumë të prekur nga ekstremizmi i dhunshëm.

Raporti është i ndarë në tri kapituj të gjerë – metodologjinë, eksplorimin e gjetjeve dhe analizën e gjetjeve – dhe përfundon me një përfundim të përgjithshëm të bazuar në gjetjet e raportit. Fillimisht përshkruhet etika e punës në terren, pastaj paraqiten vetë gjetjet, pasuar nga një analizë e gjetjeve të përmendura. Duke e ndërtuar raportin në një mënyrë të tillë, qëllimi i hulumtuesve është që lexuesit të zhvillojnë një kuptim më të thellë të kontekstit të shtetit dhe se si gjetjet e përgjithshme janë specifike për Republikën e Maqedonisë.

1.2 Historia e Shtetit

Sipas regjistrimit të fundit, të ndërmarrë në vitin 2002, popullsia e Republikës së Maqedonisë është 2.022.547. Sa i përket përkatësisë etnike të qytetarëve të saj, 6.18% janë maqedonas etnike, që përbëjnë grupin e shumicës. Shqiptarët etnikë janë grupi i dytë më i madh etnik, që përbëjnë 25.17% të popullsisë, me turqit në vendin e tretë me 3.85%, pasuar nga disa grupe të tjera etnike që përbëjnë përqindje numerikisht të vogla të popullsisë. Në përgjithësi, 33.3% e popullsisë është musliman.

mane. Bindja fetare është kryesisht e ndarë sipas vijave etnike, me shumicën e maqedonasve etnikë që praktikojnë Ortodoksinë Lindore dhe shqiptarët etnikë që praktikojnë Islamin (Enti Shtetëror i Statistikës 2002).

Këto grupe etnike dhe fetare kanë bashkëjetuar relativisht pa konflikt për shekuj, por tensione ekzistojnë; përderisa Maqedonia kryesisht shpëtoi nga konfliktet e dhunshme që rezultuan nga shpërbërja e ish-Jugosllavisë, këto tensione përfundimisht kulmuan me dhunë. Konflikti i armatosur i vitit 2001 ishte një konflikt i shkurtër midis Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare (UÇK) dhe forcave maqedonase të sigurisë. Si rezultat, 75 maqedonas udhe deri në 100 luftëtarë të UÇK-së u vranë (Bender 2013, 341).

Megjithëse i dhunshëm, konflikti i armatosur rezultoi me vdekjen e rreth 205 civilëve (Bender 2013, 341) - shumë më pak në krahasim me afro 140.000 viktima të luftërave të viteve 1990 pas shpërbërjes së ish-Jugosllavisë (Qendra Ndërkombëtare për Drejtësinë Tranzicionale 2009, 1). Paqja u ndërmjetësua nëpërmjet nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (OFA), e cila rriti të drejtat për shqiptarët etnikë që jetojnë në Maqedoni dhe vendosi rregulla për ndarjen e pushtetit midis pakicës etnike shqiptare dhe shumicës etnike maqedonase. Përkundër këtyre përfitimeve ligjore, nacionalizmi dhe shfrytëzimi i narracioneve etnike nga të dyja palët promovohen sot e kësaj dite (Popovska dhe Ristoska 2015, 63).

Sidoqoftë, ndonëse narrativet e pakënaqësive nga të dyja palët nuk kanë pasur fillimin e tyre me Konfliktin e Armatosur, ato janë krijuar me dekada të tëra – narrative specifike që çuan në konflikt të përqendruar rreth përjashtimit të perceptuar dhe faktik të shqiptarëve etnikë nga jeta qytetare në Maqedoni në aspektin ekonomik, politik, dhe shoqëror. Për maqedonasit etnikë, narrativet e pakënaqësisë u përqendruan në frikën e cenimit territorial dhe humbjes së statusit të shumicës. Përderisa kjo temë e tensionit ndëretnik dhe diskriminimit të vërtetë/të perceptuar në të dyja palët mund të jetë një raport në vete, është e rëndësishme të paraqiten narrativet bazë të të dyja palëve për të kuptuar më mirë dhe për të pozicionuar gjetjet e punës në terren.

Përderisa marrëdhëniet midis dy etnive janë përmirësuar që nga viti 2001, raporti mes tyre mbetet i brishtë. Që prej se MKO hyri në fuqi, Maqedonia ka përjetuar disa episode të dhunës etnike në shkallë të vogël, veçanërisht prej 2010 e këndeje. Këto përfshinin protesta të dhunshme, sulme ndaj policisë, sulme të motivuara etnikisht dhe rrahje. Për më tepër, këto zakonisht u rriten në numër dhe madhësi në prag të periudhave zgjedhore, mbase për shkak të partive politike nga të dyja palët që shfrytëzojnë tensionet etnike si pjesë e strategjive të tyre zgjedhore.

Tensioni ndërmjet të dyja palëve ka rezultuar në dy fusha ndjeshmërie të kundërta dhe reciprokisht të përforcuara: në përgjithësi, shqiptarët përjetojnë diskriminim faktik dhe të perceptuar dhe izolim nga shumica etnike maqedonase, dhe maqedonasit etnikë, përmes ngjarjeve të ndryshme politike dhe fuqizimit të shqiptarëve, përjetojnë perceptimin e humbjes së rëndësisë dhe statusit.¹ Këto tensione kanë potencialin që narrativet e ekstremizmit të dhunshëm të jenë më tërheqës për të dyja palët dhe të lënë hapësirë potenciale për shfaqjen e radikalizmit.

Kohëve të fundit, një konflikt politik përfshiu Republikën e Maqedonisë, dhe pasojat ligjore akoma ndjehen deri më sot. Ish-qeveria, nën udhëheqjen e kryeministrit Nikola Gruevski, u përfshi në një krizë politike për shkak të zbulimit të një skandali masiv përgjimi që përfshiu partinë VM-RO-DPMNE, atë kohë në pushtet (Bechev 2017). Kriza politike u kapërcye vetëm me nënshkrimin e Marrëveshjes së Përzahinos në korrik të vitit 2015, dhe zgjedhjet u mbajtën më pas në dhjetor të 2016 (Komisioni Evropian 2015). Gjatë krizës politike dhe ciklit të mëvonshëm të zgjedhjeve, tensionet etnike u ushqyen nga frika, propaganda dhe vendosja politike e një narrativi etno-nacionalist kundër tjetrit për përfitime të perceptuara politike. Pas formimit të qeverisë nga kryeministrit i tanishëm Zoran Zaev, zgjedhja e një shqiptari etnik si kryetar i parlamentit çoi në pushtimin e parlamentit nga nacionalistët maqedonas që protestonin kundër zgjedhjes së tij; dhe si rezultat nga kjo, 77 parlamentarë u plagosën në kacafytje (Day dhe Sherlock 2017). Përderisa ngjarjet që u përshkruan janë në një nivel të lartë politik, ndezja e tensioneve etnike dhe pasiguria politike u ndje pa dyshim në nivel lokal nga qytetarët e zakonshëm.

Përkundër këtyre incidenteve fillestare të dhunës, nga pikëpamja politike zgjedhja e qeverisë së re mban potencialin për angazhim dhe ndërveprim të përmirësuar midis maqedonasve etnikë dhe shqiptarëve etnikë. Megjithatë, kushtet që çuan në zhvillimin e fenomenit të luftëtarit të huaj akoma mbeten kryesisht të pandryshuara dhe si të tilla duhet të adresohen derisa ekstremizmi i dhunshëm të zhduket plotësisht.

¹ Deri në konfliktin e 2001-shit, mes tjerash shqiptarët përballëshin me diskriminim në çështjet e punësimit në sektorin publik, qasjen deri tek edukimi, mungesën e qasjes deri tek materialet në gjuhën e tyre amtare. Pas implementimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit, shumë nga të drejtat ju dhanë shqiptarëve, të cilën gjë maqedonasit e panë si të padrejtë. Për më shumë diskutim, shih Cecik dhe Petkovska-Hristova 2014.

1.3 Ekstremizmi i dhunshëm në Maqedoni - Një vështrim i përgjithshëm

Që nga viti 2018, 150 qytetarë të Maqedonisë u larguan nga vendi si luftëtarë të huaj për t'u bashkuar me formacionet paraushtarake në Siri dhe Irak (përgjigje përmes Qasjes deri tek informacione me karakter publik, MPB). Shumica dërrmuese e këtyre luftëtarëve të huaj ishin shqiptarë etnikë myslimanë (Stojkovski dhe Kalajdziovski 2018). Krahasuar me vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor, Maqedonia ka numrin më të lartë për banorë (per capita) të luftëtarëve të huaj që rrjedhin nga popullsia e saj myslimane - 1 në 4,545 njerëz² (shih: Tabela 1). Për më tepër, Maqedonia ka numrin e dytë më të lartë të të kthyerve (80) në mesin e fqinjëve të saj rajonalë, e dyta vetëm pas Kosovës me 130 (Azinovic 2018, 9). Siç theksojnë Stojkovski dhe Kalajdziovski (2018, 12), këto shifra parashetrojnë pyetje të rëndësishme për nivelet e përgjithshme të ekstremizmit jo të dhunshëm që gjendet brenda popullsisë myslimane në Maqedoni.

Tabela 1: Rekrutimi i luftëtarëve të huaj në mesin e popullatave myslimane në Ballkanin Perëndimor

Shteti	luftëtarë të huaj për 100,000 muslimanë	përhapja e luftëtarëve të huaj në popullatën muslimane
Shqipëri	71	in 14,286
Bosnjë dhe Hercegovinë	13	1 in 7,692
Maqedoni	22	1 in 4,545
Kosovë	18	1 in 5,555
Mal i Zi	19	1 in 5,263
Sërbi	22	1 in 4,545

Burimi: Azinovic 2018, 6.

Për më tepër, sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, nuk ka pasur asnjë largim të shënuar të luftëtarëve të huaj që nga viti 2017 (përgjigje përmes Qasjes deri tek informacione me karakter publik, MPB). Hulumtimi sekondar gjithashtu tregon se që nga viti 2017, lëvizjet e luftëtarëve të huaj nga Maqedonia kanë pushuar në mënyrë efektive, kryesisht për shkaqe që lidhen me vështirësinë e arritjes deri në Siri dhe Irak, duke pasur parasysh legjislativin e ri mbi terrorizmin, si dhe shpërbërjen e territorit në Siri dhe Irak nën kontrollin e Shtetit Islamik të Irakut dhe Levantit (ISIL) (Stojkovski dhe Kalajdziovski 2018, 12). Megjithatë, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se mbështetja për idetë ekstremiste është zhdukur; përkundrazi, ata ekstremistë që janë kanë prirje të dhunshme nuk kanë më një pikësynim të huaj, gjë që ngre çështje të rëndësishme politike lidhur me nivelin dhe fushën e kërcënimit në territor të Maqedonisë vis-a-vis potencialit të atyre individëve për të kryesulme të brendshme. Për më tepër, në kontekstin rajonal me numrin e madh të të kthyerve tani në Maqedoni, është e rëndësishme që tani edhe përpjekjet e P/CVE të ndryshojnë për t'iu drejtuar atyre që janë kthyer. Duke pasur parasysh mungesën e programeve të ri-integrimit dhe rehabilitimit për t'u marrë me të kthyerit (Stojkovski dhe Kalajdziovski 2018), peizazhi i brendshëm po bëhet gjithnjë e më i ndërlikuar dhe problematik.

1.4 Qasjet aktuale ndaj programeve të P/CVE

Që nga shkurti i 2018-ës, Republika e Maqedonisë miratoi strategjinë e saj të parë P/CVE si pjesë e një përpjekjeje më të gjerë në luftën kundër terrorizmit. Kjo është pjesë e një strategjie katërveçare (2018-2022) e paraqitur nga qeveria aktuale e Zaevit, e cila synon të harmonizojë përpjekjet P/CVE dhe të kundër-terrorizmit të Maqedonisë me ato të Kombeve të Bashkuara (KB) dhe Bashkimit Evropian (BE). Përderisa ky është një hap pozitiv, miratimi i një strategjie të tillë ka ardhur disa vite pas zbatimit të strategjive P/CVE nga vendet tjera të Ballkanit Perëndimor. Për më tepër, vetë strategjia nuk është mjaftueshëm gjithëpërfshirëse, duke i munguar ekspertiza, dhe përqendrohet kryesisht në aspektet e sigurisë dhe zbatimit të ligjit për P/CVE - bën pak për të pranuar se ekstremizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm nuk janë vetëm një çështje sigurie, por një çështje shoqërore po ashtu.

² Të barabartë për vendin e parë me Serbinë.

Sa i përket personelit që është përgjegjës për P/CVE, para vitit 2017 nuk ekzistonte një trup koordinues. Për një kohë të shkurtër, kishte një koordinator për kundër-terrorizëm, i cili po ashtu punonte edhe në P/CVE. Pasi largimit, pozicioni i tij mbeti vakant për një vit e gjysmë. Emërimi i koordinatoreve në Qershor, 2017 me fokus edhe në P/CVE përkrah kundër-terrorizmit është një hap tejet pozitiv të ndryshimin e fokusit nga qasja e "sekuritizimit" në një qasje më gjithëpërfshirëse, e fokusuar në aspektin shoqëror të ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, edhe pse një koordinator kombëtar i P/CVE dhe zëvendës koordinator u emëruan në qershor të vitit 2017, këta individë nuk kanë burime njerëzore dhe materiale për të zbatuar këtë strategji. Për shembull, përkundër krijimit dhe emërimit të këtyre pozicioneve në qershor të vitit 2017, koordinatoreve qeveria nuk u dha hapësirë fizike për zyrë në të cilën ata do të përmbushnin detyrimet e tyre³. Në të njëjtën kohë, komuniteti ndërkombëtar ju ka dhënë mbështetje të madhe koordinatoreve: Misioni i OSBE në Shkup dhe Ambasadat e SHBA-ve dhe Mbretërisë së Bashkuar ju kanë ndihmuar në përgatitjen e strategjisë dhe organizimin e tryezave të rrumbullakëta të diskutimit me përfaqësues të komuniteteve.

Nga këndvështrimi i shoqërisë civile, përpjekjet e P/CVE kanë qenë tradicionalisht mjaft të zbehta në terren. Janë ndërmarrë disa iniciativa, siç është projekti Mother Schools (Shkolla e Nënave) i realizuar në Çair nga Women Without Borders (Gratë Pa Kufij) ose programi Educate2Prevent (Eduko për të Parandaluar) i realizuar nga Nexus Civil Concept dhe partnerët e tyre. Projekti i Mother Schools është një projekt ndërkombëtar, i cili synon të rrisë ndërgjegjësimin se si të kundërvihet ekstremizmi; ai kërkon të rrisë kompetencat dhe aftësitë e nënave duke i fuqizuar ato për të ndihmuar në ndërtimin e strategjive të bazuara në komunitet për të kundërshtuar ideologjitë radikale. Ngjashëm, Educate2Prevent synon t'u mundësojë prindërve dhe të punësuarve nëpër shkolla (që janë linja e pare e frontit) për të ndihmuar në identifikimin dhe parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm në mesin e të rinjve. Megjithatë, sado ambicioz në fushën e tyre, nuk ka dëshmi për të përcaktuar efektivitetin e këtyre iniciativave.

Përveç këtyre projekteve dhe programeve, ka pasur edhe disa përpjekje tjetra kërkimore që kanë të bëjnë me P/CVE nga Organizata Ndërkombëtare për Migracionin (IOM), Analytica Think Tank dhe Këshilli Britanik (British Council).

Së fundmi, është e rëndësishme që shkurtimisht të diskutojmë mbi marrëdhënien e mundshme midis zbatimit të përpjekjeve për ndërtimin e paqes në Maqedoni pas Konfliktit të Armatosur të vitit 2001, statusit aktual të marrëdhënieve etnike në të gjithë vendin, dhe ekstremizmit. Duke pasur parasysh natyrën e Konfliktit të Armatosur që ndodhi në Maqedoni, ndërtimi i paqes ishte padyshim një përpjekje për të kapërcyer boshllëqet që ekzistonin midis shqiptarëve etnikë dhe maqedonasve etnikë pas shpërthimit të dhunës në vitin 2001. Megjithatë, pjesa më e madhe e kritikës ndaj periudhës pas MKO-së ka qenë e lidhur me zbatimin e saj – ndërkohë që ka pasur ndryshime të konsiderueshme strukturore që janë zbatuar në nivel shtetëror dhe komunal për të adresuar çështjet etnike, pak është bërë për të zbatuar aktivitete të përbashkëta, afatgjate, lokale, të ndërtimit të paqes.

Në përgjithësi, MKO - marrëveshja që rezultoi me ndërprerjen e dhunës – siguroi kuadrin për përfaqësimin e barabartë të shqiptarëve etnikë brenda qeverisë. Përderisa paqja sigurisht që ishte e mirëpritur dhe shihej si një rezultat pozitiv, kritikën për MKO-në kanë ardhur nga të gjitha anët. Disa kritikë të MKO-së pohojnë se ajo "promovon kolektivin në krahasim me të drejtat individuale [...] si rrjedhim, shqiptarët tani identifikohen si një kolektiv sesa si shtetas të Maqedonisë" (Pearson 2002, 6), që i bëri disa shqiptarë etnikë ta shohin MKO-në të zbatuar në mënyrë jokonsistente (Milovanoviç-Fazliu, 2015). Për më tepër, disa maqedonas etnikë e interpretojnë MKO-në si "përfundimi i konfliktit", por jo edhe "përfundimi i burimeve të konfliktit" (Reka, 2011) dhe në këtë mënyrë i vazhdojnë ankesat nga ana e tyre për atë që ata e shohin si agresion territorial shqiptar. Si i tillë, një mentalitet "ne kundrejt atyre" ka vazhduar të lulëzojë në disa komunitete në Maqedoni – si për maqedonasit etnikë ashtu edhe për shqiptarët etnikë – duke lënë kështu një ambient që është potencialisht i favorshëm që narrativet ekstremiste të marrin jetë.

Si konkluzion, ndërkohë që diskutimi mbi zbatimin post-konflikt të MKO-së në Maqedoni është një temë e denjë për një raport të gjerë të vetë saj, përpjekja këtu është të shihet se sa efektive zbatimi i cilësdo strategji P/CVE mund të jetë pa marrë parasysh pasojat e MKO-së dhe se sa realisht të qëndrueshme strategjitë e tilla mund të jenë pa adresuar rezultatet e mbetura shoqërore dhe realitetet e periudhës pas Konfliktit të Armatosur.

³ Që nga mesi i vitit 2018, koordinatorët tani kanë një zyrë.


2 Metodologjia

Ky hulumtim synon të ofrojë një pasqyrë në tri komuna të ndryshme në Republikën e Maqedonisë – Çair, Gostivar dhe Strugë – dhe kërkon të kuptojë se çfarë e bën një komunë të prekur apo të paprekur nga përhapja e ekstremizmit të dhunshëm. Ky është në kontrast me raportimet e mëparshme mbi këtë temë, i cili në përgjithësi ka dhënë një pasqyrë të gjerë të ekstremizmit të dhunshëm brenda kontekstit të Maqedonisë.

Çairi, Gostivari dhe Struga⁴ u përzgjedhën si “lokacione” të hetimit bazuar në nivelet e tyre të perceptuara të ndikimit nga ekstremizmi i dhunshëm, siç ishte përcaktuar nga hulumtuesit. Kjo përzgjedhje e komunave u bazua në njohuritë dhe përvojën e mëparshme të kërkuesve mbi këtë temë brenda kontekstit të Maqedonisë, dhe mbi numrat e luftëtarëve të huaj që dilnin nga këto komuna. Duke u bazuar në këtë analizë, kërkuesit e identifikuan Çairin si shumë të prekur, Gostivarin si të prekur mesatarisht dhe Strugën relativisht të paprekur nga ekstremizmi i dhunshëm.

Këto komuna janë kryesisht etnikisht shqiptare, të ngjashme në përmasat e popullsisë dhe të gjitha janë zona urbane. Çairi është një nga dhjetë komunat që formojnë kryeqytetin e Maqedonisë, Shkupin, dhe strehon një popullsi prej rreth 65.000 banorë (Makedonija.name, 2018). Struga dhe Gostivari janë qytete të veçanta që ndodhen brenda rajonit perëndimor të Maqedonisë që kufizohet me Shqipërinë. Popullatat e tyre janë 37.000 dhe 51.000, respektivisht (World Population Review, 2018). Megjithatë, meqë regjistrimi i fundit në Maqedoni u bë në vitin 2002, numrat në lidhje me arritjet arsimore, punësimin dhe të dhënat e tjera socio-ekonomike që janë të rëndësishme për këtë analizë, janë të pa-azhuruara.

Përderisa të tri komunat janë multietnike, Çairi shihet si pjesa më etnikisht e ndarë nga të tri – në fakt, nga cilado komunë në Republikën e Maqedonisë - dhe karakterizohet me tensione të larta midis shqiptarëve etnikë dhe maqedonasve etnikë. Për më tepër, ndërsa vetë Çairi është me shumicë etnike shqiptare, është vetëm një komunë e Shkupit, një qytet ku shumica e popullsisë është etnikisht maqedonase.



Burimi: Enti Shtetëror i Statistikës (www.stat.gov.mk)

⁴ Shih hartën për lokacionet e komunave, të rrethuar me të kuqe. Vini re se Çairi është një nga dhjetë komunat që formojnë qytetin e Shkupit

2.1 Konceptet dhe terminologjia

Para se të angazhohemi më tej me metodologjinë, është e rëndësishme të përkufizojmë atë që nënkuptohet me termat radikalizim, ekstremizëm dhe ekstremizëm i dhunshëm. Në vend që të angazhohemi në një debat të gjerë akademik rreth interpretimeve të panumërta të këtyre termave, për qëllimet e këtij raporti, hulumtuesit kanë zgjedhur përkufizime specifike për terminologjitë e lartpërmendura.

Sipas Mohammed Hafez dhe Creighton Mullins (2015, 960), radikalizmi “përfshin miratimin e një botëkuptimi ekstremist, një që është hedhur poshtë nga shoqëria mainstream dhe një që e konsideron të ligjshme përdorimin e dhunës si një metodë për të ndikuar në ndryshimet shoqërore apo politike”. Brenda kontekstit të këtij raporti, një “botëkuptim ekstremist” i referohet ekstremizmit Islamist; që është një lloj ekstremizmi “i bazuar në një ideologji politike të Islamizmit” (Mahood dhe Rane 2017, 17), që sipas qeverisë britanike përbën një “refuzim absolut të demokracisë, lirisë personale dhe të drejtave të njeriut, si dhe një angazhim për rivendosjen e një kalifati të vetëshpallur dhe krijimin e një interpretimi brutal dhe tekstual të ligjit të sheriatit “(Qeveria e Britanisë së Madhe 2018, 16). Në kuptimin më të saktë dhe më të gjerë, një individ ekstremist përkrah një botëkuptim të tillë, por nuk është i angazhuar në dhunë drejt zbatimit të tij.

Më tej, sipas USAID-it (2011, 2), **ekstremizmi i dhunshëm** “i referohet avokimit, angazhimit ose mbështetjes së dhunës të motivuar ose të justifikuar ideologjikisht për objektiva të mëtejshme sociale, ekonomike dhe politike”. Si i tillë, ekstremizmi i dhunshëm përcaktohet nga dhuna e veprimeve të ndërmarra në përputhje me dhe në mbështetje të narrativeve dhe objektivave ekstremiste. Është e rëndësishme të theksohet se të gjitha këto dukuri janë të ndryshme nga terrorizmi, i cili gjithashtu është i gjerë në përkufizim, por mund t’i referohet “çdo veprimi ... që synon të shkaktojë vdekje ose dëmtime të rënda trupore civilëve ose jo luftëtarëve, kur qëllimi i një akti të tillë është të frikësojë një popullatë ose të detyrojë një qeveri ose organizatë ndërkombëtare për të bërë ose për të mos bërë ndonjë veprim.⁵

Megjithatë, është e rëndësishme të theksohet se jo të gjithë individët që përkrahin një botëkuptim ekstremist siç është përcaktuar më sipër do të bëhen të dhunshëm; përkundrazi, përderisa disa mund t’i kthehen dhunës, të tjerët mund të mbeten vetëm ideologjikisht ekstrem. Po aq e rëndësishme, për më tepër, është kuptimi se vetëm për shkak se një individ nuk bëhet ekstremist i dhunshëm nuk do të thotë se ata nuk përbëjnë një kërcënim potencial. Ekstremizmi jo i dhunshëm mund të ushqejë një mjedis që është i favorshëm për ekstremizmin e dhunshëm, ku individët që akoma nuk janë të dhunshëm mund të marrin më lehtë hapin drejt dhunës. Individët që janë akoma-jo-të-dhunshëm ndryshojnë nga ata që nuk janë të dhunshëm në kuptimin që mos-përdorimi i dhunës paraprakisht “është bazuar thjesht në konsiderata pragmatike, taktike dhe/ose të përkohshme [...] jo në një filozofi politike parimore (Schmid 2014, 14). Prandaj, ekstremistit jo-akoma-të-dhunshëm nuk i mungon dëshira për dhunë – por vetëm mjetet.

2.2 Projektimi i punës në teren

Puna në terren u zhvillua në lokacione brenda tri komunave, ku u mbajtën edhe intervistat dhe grupet e fokusit., Përveç gjashtë intervistave në Çair, nëntë intervistave në Strugë dhe shtatë intervistave në Gostivar, në përgjithësi, në secilën komunë u zhvilluan tri fokus grupe.

Intervistat gjysmë të strukturuar u zhvilluan me aktorë relevantë lokalë, duke përfshirë përfaqësuesit e OJQ-ve, mësuesit, drejtuesit e qeverisë lokale dhe figurat fetare. Arsytimi për përfshirjen e këtyre zërave në kuadër të hulumtimit ishte të identifikohet se si çështjet e ekstremizmit të dhunshëm dhe ndikimet në komunitet janë perceptuar nga aktorët lokal dhe palët e interesuara, dhe që përfshijnë një gamë të gjerë perspektivash brenda databazës së raportit. Ekipi hulumtues u siguria që të intervistuarit të ishin figura autoritare në temën e parandalimit dhe të kundërvënies ndaj ekstremizmit të dhunshëm, lidhur me fushat e tyre të ndryshme, dhe përgjigjet e tyre u analizuan për përcaktimin e trendeve dhe ngjashmërive. Së fundi, për qasje në këta individë nuk kishte nevojë për lehtësues; përkundrazi, rrjeti i gjerë i kontakteve të hulumtuesve brenda vendit u tregua i mjaftueshëm në këtë drejtim.

Në çdo komunë u zhvilluan një sërë fokus grupesh, dhe u ndanë në linja të ndryshme demografike. Përpyekja këtu ishte të sigurohej që diversiteti të përfaqësohej në sa më shumë kategori të jetë e mundur. Në secilën komunë, ishte një grup i fokusit që përfshinte individë brenda intervalit të moshës 18-25 vjeç, si dhe një grup tjetër për individët brenda intervalit të moshës 25-45 vjeç; të dyja

⁵ Kombet e Bashkuara 2004. Cituar në Schmid 2004:393-394.

këto grupe ishin me gjini të përziera. Gjithashtu, ishte e rëndësishme për hulumtuesit që të zhvillonin një grup të fokusit në secilën komunë që ishte vetëm-femra. Kjo ishte shkruar në planin e hulumtimit për të mundësuar më mirë dëgjimin e zërave të grave, pasi rolet gjinore në grupe të caktuara etnike në Maqedoni i bëjnë gratë të ndihen më pak të fuqizuara në mjedise të përziera gjinore; në këtë mënyrë, grupet e fokusit vetëm-femra u projektuan për t'i bërë gratë të ndihen më të rehatshme duke shprehur mendimet e tyre mbi temën e hulumtimit.

Megjithëse grupet e fokusit u kategorizuan në bazë të moshës demografike dhe gjinore, kishte një ngjashmëri për të gjitha grupet e mbajtura – hulumtuesit siguruan që secili grup të ishte multi-etnik. Kjo ishte shkruar në planin e hulumtimit për dy arsye kryesore. Së pari, duhej siguarur që asnjë grup etnik i veçantë të mos përjashtohej, të mbi-përfaqësohej, të bënte të ndihej i izoluar ose të veçohej për t'u parë si “ekstrem”. Së dyti, ishte e rëndësishme që hulumtimi të përfaqësonte, sa më shumë që të jetë e mundur, përbërjen etnike të Republikës së Maqedonisë, duke ofruar kështu një përshkrim më të pasur se si specifikat lokale mund të kontribuojnë në prekshmërinë ose jo-prekshmërinë e një komune.

Për të mbledhur të dhënat e punës në terren, hulumtuesit kryesisht morën shënime gjatë intervistave dhe fokus grupeve. Përderisa disa nga intervistat u regjistruan, hulumtuesit u përpoqën që të mos mbështeteshin shumë në këtë metodë, pasi mendonin se pjesëmarrësit do të ndiheshin më të rehatshëm dhe më të lirë për t'u shprehur në një temë kaq të ndjeshme pa shtuar presionin e regjistrimit. Aty ku u bënë regjistrime, ato u ruajtën në mënyrë të sigurtë në zyrat e menaxherit të projektit.

Mbledhja e të dhënave të hulumtimit mbeti korrekte nga pikëpamja etike, pasi pjesëmarrësit nuk u emëruan, e as nuk u kërkuan të zbulonin informacione të cilat mund t'i vendosnin në situata të rrezikshme. Pjesëmarrësit u lanë të flasin lirshëm për atë që ata e konsideronin të përshtatshme dhe nuk ishin të shtyrë të flisnin për tema për të cilat ata ndiheshin të përehatshëm. Intervistat dhe pyetjet pasuese ishin të hapura dhe objektive, dhe të dizajnuara për të shkaktuar nxitjen e mendimeve individuale në vend të drejtimit të individëve në ndonjë drejtim të veçantë. Për më tepër, hulumtuesit synonin të ofronin mjedise të rehatshme, jo-gjyqese për intervistat dhe fokus grupet.

2.3 Korniza Analitike

Për të ndërmarrë analizën e tij, ky raport përdor një interpretim të Teorisë Puzzle të Mohammed Hafez dhe Creighton Mullins, e cila është një sintezë teorike për të kuptuar rrugët deri te ekstremizmi i dhunshëm. Propozon katër faktorë – pakënaqësitë personale dhe kolektive, rrjetet dhe lidhjet ndër-personale, ideologjitë politike dhe fetare, si dhe krijimin e mjediseve dhe strukturave mbështetëse – si kornizë e saj për analiza. Megjithatë, bazuar në gjetjet e punës në terren, ky raport ka zgjedhur të sintetizojë këta katër faktorë në tre faktorë më të gjerë:

- Mjediset mundësuese dhe strukturat mbështetëse
- Ideologjitë ekstreme, rrjetet dhe lidhjet ndër-personale
- Pakënaqësitë kolektive dhe personale⁶

Korniza e Hafez dhe Mullins u përdor si një kornizë e analizës, sepse ajo rrjedh nga një sintezë e hulumtimit empirik mbi temën e radikalizmit, dhe konkludon se faktorët e sipërpërmendur janë të identifikuar dhe të ekzaminuar më së shumti brenda asaj mase të literaturës. Si të tillë, faktorët janë një mishërim i një konsensusi shkencor. Për më tepër, teoria siguron hapësirë për një analizë që është e vetëdijshme për faktin që edhe pse faktorët shfaqen brenda thelbit akademik të punës, “konteksti dhe rrethanat e konvergencës së tyre ndryshojnë”. Siç Hafez dhe Mullins (2015, 961) shpjegojnë:

Të konstruara në mënyrë të ngjashme si puzzle-at që mund të zbulojnë imazhe të ndryshme pasi pjesët e tyre të jenë të ndërlidhura, rastet e radikalizmit mund të shfaqin shumëllojshmëri të jashtëzakonshme edhe kur variablat e radikalizimit përsëriten.

Në këtë mënyrë, teoria e Hafez dhe Mullins ofron një kornizë përmes së cilës mund të paraqitet radikalizimi drejt ekstremizmit të dhunshëm si një proces multifaktor që është po aq i ndryshëm dhe multidimensional. Një kornizë e tillë siguron që një qasje e kontekstualizuar mund të përkrahet për të kuptuar trajektoren e individit ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

⁶ Katër faktorët e gjetur në teorinë e Hafez dhe Mullins u sintetizuan në këto tre faktorë më të gjërë për të reflektuar më mirë trendet e gjetura në të dhënat në terren

2.4 Kufizimet në kërkime

Të dhënat e mbledhura përmes punës në terren janë cilësore nga natyra e tyre. Megjithatë, në shumicën e rrethanave, për shkak të mjedisit të-qasjes-në-informata në Maqedoni, është e vështirë të plotësohen këto të dhëna cilësore me të dhëna sasiore. Raporti duhet të mbështetet vetëm në perceptimet dhe përvojat e atyre individëve që jetonin në komunat e hulumtuara, pasi që ishte e vështirë për të marrë statistika specifike dhe të dhëna numerike në lidhje me rastet e ekstremizmit të dhunshëm brenda këtyre komunave për shkak të kufizimeve në lidhje me zbulimin e informacioneve qeveritare.

Për më tepër, për shkak të kufizimeve ligjore, hulumtuesit nuk mund të angazhoheshin drejtpërdrejtë me cilindo nga individët që kishin lënë këto komuna për t'u bërë luftëtarë të huaj⁷. Një angazhim i tillë do t'u ofronte hulumtuesve një pamje më gjithëpërfshirëse në atë se çfarë ndikon në ndjeshmërinë e një individi ndaj ekstremizmit të dhunshëm. Si i tillë, hulumtimi është i kufizuar në përshkrimin e faktorëve të perceptuar që çojnë në ekstremizmin e dhunshëm, të marrë nëpërmjet observimit.

Së fundmi, hulumtuesit u përpoqën të mënjanojnë çdo paragjykim të mundshëm personal që kishin ndaj çështjes duke hartuar pyetjet e hulumtimit dhe pyetjet pasuese për të dyja intervistat dhe grupet e fokusit të jenë të hapura dhe jo-drejtuara.

3 Eksplorimi i gjetjeve

Pa i kuptuar faktorët që çojnë në ekstremizmin e dhunshëm në kontekstin e Maqedonisë, është e pamundur të diskutohet se çfarë e bën një komunë dhe individët atje më shumë ose më pak rezistent ndaj thirrjeve ekstremiste. Për tri komunat e shqyrtuara në këtë raport – Çair, Gostivar dhe Strugë - kjo pjesë kërkon të prezantojë dhe të shqyrtojë një pasqyrë tematike të dobësive të vërejtura gjatë kryerjes së punës në terren.

3.1 Qasjet Analitike

Siç është artikulluar në kapitullin e metodologjisë, këto gjetje do të paraqiten bazuar në një metodologji të zhvilluar nga Mohammed Hafez dhe Creighton Mullins, në punën e tyre teorike mbi qasjet empirike ndaj ekstremizmit vendor⁸.

Përderisa metodologjia e Hafez dhe Mullins argumenton se ka katër faktorë të cilët, në nivele të ndryshme të ndërlikohjes, bashkohen për të prodhuar ekstremizëm të dhunshëm, ky raport i ka sintetizuar ato në tre faktorë të gjerë bazuar në gjetjet e punës në terren. Për më tepër, duhet të theksohet se në ndërkohë që gjetjet janë kategorizuar në këtë mënyrë, mbulimi njëri mbi tjetrin dhe interkonektiviteti midis këtyre faktorëve është ajo që i jep metodologjisë bazë qëndrimit e saj në shqyrtimin e rrugëve për ekstremizmin e dhunshëm. Përfundimisht, faktorët që janë më tepër tematikisht të strukturuar në natyrën e tyre janë paraqitur të parët, të ndjekur nga ata që janë individual, në përpjekje për të kuptuar se si dobësitë në nivel më të gjerë strukturor rrjedhin dhe ndikojnë në nivelin individual, bazik.

⁷ Kufizimet ligjore të përmendura këtu i referohen Nenit 322-A të kodit penal të Maqedonisë, i cili u prezantua për të trajtuar ekstremizmin e dhunshëm dhe rrjedhën e luftëtarëve të huaj nga vendi. Ky artikull gjithashtu thotë gjerësisht se nëse një individ ka ndonjë informacion në lidhje me ekstremizmin e dhunshëm, ai individ duhet ta raportojë atë në polici ose të përballet me deri në pesë vjet burgim. Kjo pengoi qasjen e kërkuesve në informata për atë që intervistuarit potencialë me lidhje të dyshuar të drejtpërdrejtë ose dytësore me ekstremizmin e dhunshëm nuk kishin dëshirë të intervistoheshin. Përveç kësaj, kjo bëri të pamundur mundësinë e kërkuesve të kryejnë intervista me ekstremistët e dhunshëm në burg, duke shtuar më tej mundësinë e hulumtuesve për t'u angazhuar me të kthyerit ose individët e burgosur për veprat penale të lidhura me terrorizmin.

⁸ Për më shumë mbi këtë metodologji, ju lutemi shihni: M. Hafez dhe C. Mullins (2015). "Misteri i radikalizimit: një sintezë teorike e qasjeve empirike për ekstremizmin vendor" *Studies in Conflict and Terrorism* 38: 958-975.

Të tre faktorët janë si më poshtë (bazuar në Hafez dhe Mullins 2015, 961):

- 1) Mjedise e përshtatshme (ang. Enabling environments) dhe strukturat mbështetëse
 - Këta faktorë kanë të bëjnë me cilësitë fizike dhe virtuale, duke lëvizur nga qasja në materialet ekstremiste si në botën virtuale ashtu edhe në atë reale, në “vendndodhjet” e ekstremizmit, si para xhemaatë dhe objektet edukuese ekstremiste
 - Po ashtu, “mjediset” mund të jenë në lidhje me një pikëpamje të nivelit-të-lartë si të shoqërive ashtu edhe komunave në përgjithësi, dhe se si ato mjedise mund të jenë të favorshme për zhvillimin e narrativët ekstremiste.
- 2) Ideologjitë ekstreme, rrjetet dhe lidhjet ndër-personale
 - Ndikimi i “narrativeve master (ang. master narratives) për botën” që “krijojnë pakënaqësitë personale dhe kolektive në kritikën e përgjithshme politike të status quo”
 - Ideologjitë mund të përhapen, shpërndahen dhe autentifikohen nëpërmjet rrjeteve dhe lidhjeve ndër-personale
 - Rrjetet si mjedise ofrojnë “mundësi për socializim me radikalët”, kënaqësinë e “nevojave psikologjike si kërkimi i marrëdhënieve kuptimplote dhe kërkimi i domethënies” dhe ato gjithashtu mund të “kapin individët përmes dinamikës së presionit të bashkëmoshatarëve [dhe] mendimit në grup” që mund “të rrisë çmimin e largimit dhe të përforcojë dedikimin ndaj dhunës”
- 3) Pakënaqësitë kolektive dhe personale
 - Përdorimi/keqpërdorimi i narrativëve të pakënaqësive të tilla si tjetërsimi kulturor ose marginalizimi ekonomik, ndjenjat e viktimizimit dhe pakënaqësitë personale dhe krizat që çojnë “të kërkojë një rrugë të re në jetë”

Pasi të paraqitet kjo pasqyrë tematike, gjetjet do të përfshihen në fushat e perceptuara të qëndrueshmërisë dhe do të diskutojnë secila brenda kontekstit të komunave të Çairit, Gostivarit dhe Strugës. Duke u bazuar në këtë seksion, kapitulli pasues do të angazhohet në një analizë më të gjerë të ndërveprimit ndërmjet faktorëve të ndjeshmërisë dhe qëndrueshmërisë dhe do të diskutojë se si këta faktorë e formësojnë dinamikën e komunave në fjalë përballë kërcënimit që vjen nga ekstremizmi i dhunshëm.

3.2 Faktorët e vulnerabilitetit

3.2.1 Mjediset e përshtatshme dhe Strukturat Mbështetëse

Tensionit Ndër-Etnik i Vazhduar si një Vulnerabilitet

Megjithëse i artikulluar më pak në mënyrë eksplicite nga të anketuarit në disa komuna, faktori themelor dominues në të gjitha, nga një nivel i gjerë strategjik, ishte tensioni ndër-etnik-shpesh-i-paadresuar, që sfidon Maqedoninë në tërësi. Siç u përmend më parë, një nga faktorët përcaktues për Maqedoninë në periudhën pas Konfliktit të Armatosur ishte menaxhimi i asaj që u bë një shoqëri strukturore multietnike pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit dhe zhvillimeve pasuese pas atij akordi. Përderisa Marrëveshja vendosi bazat për rritjen e të drejtave të shqiptarëve dhe formalizoi marrëveshjet e ndarjes së pushtetit, vendi ka parë përlëshje etnike sporadike dhe rritjen e identiteteve etnike në nivel shtetëror për përfitime politike. Në rastin më të mirë, situata ka mbetur e pasigurtë, dhe në rastin më të keq, ka ofruar narrative të shfrytëzueshme për ideologët dhe rekrutuesit ekstremistë. Për më tepër, realiteti që pothuajse të gjithë luftëtarët e huaj të Maqedonisë në Irak dhe Siri kanë qenë shqiptarët etnik thekson nocionin se etnia, duke mos qenë vetë në vetë një faktor përcaktues i radikalizmit, është e lidhur me kushtet që e bëjnë një individ më të prekshëm ndaj ekstremizmit, dhe kjo është kryesisht për shkak të përcaktimeve socio-politike brenda kontekstit të Maqedonisë.

Nëse dikush do të hetonte strukturën politike të Maqedonisë në nivel shtetëror në periudhën pas Konfliktit të Armatosur, është e mundur të shihet se si veprimet politike të ndërmarra gjatë kësaj periudhe kanë ndikuar në krijimin e një “mjedisi të përshtatshëm” për ekstremizmin brenda vendit. Në raportin e tyre për çështjet e radikalizmit në Maqedoni, puna në terren e Qehaja dhe Perteshi (2018, 8) zbuloi se në mesin e të anketuarve të tyre kishte një ndjenjë mbizotëruese që sundimi na-

cionalist nën VMRO-DPMNE nga 2006-2015 u njoh nga përpjekjet e qeverisë për të “ të mbajtur një situatë të tensionuar ndër-etnike për të nxitur frikën me qëllim për të ruajtur dominimin e tyre në politikën e Maqedonisë “.

Gjatë kësaj periudhe, Qehaja dhe Perteshi (2018, 8) dëshmojnë se shqiptarët etnik “shpesh ishin të margjinalizuar, duke çuar shumë individë për të kërkuar alternativa, që përfshinin pjesëmarrjen në grupet radikale”. Për më tepër, në dëshminë e saj për Komitetin e Senatit të Shteteve të Bashkuara për Marrëdhënie të Jashtme, Nënkomiteti për Evropën dhe Bashkëpunimi Rajonal mbi Sigurinë, Dr. Majda Ruge (2017) argumentoi se “sundimi nacionalist [është] drejtuesi i vetëm më i rëndësishëm kombëtar i [...] radikalizmit” në rajonin e Ballkanit Perëndimor, në të cilin udhëheqësit nacionalistë “parandalojnë pajtimin duke manipuluar ndarjet shoqërore në mënyrë që të shpërquandojnë dështimet e tyre në qeverisje”.

Përderisa detajet e kontekstit të Maqedonisë të pas Konfliktit të Armatosur janë unike, faktorët mbizotërues që çojnë në këtë brishtësi nuk janë unik brenda Ballkanit Perëndimor. Siç Karakatsanis dhe Herzog (2016, 199-204) parashtrojnë:

Shfaqja e politikës së grindjeve në Evropën Juglindore në fund të viteve 2000 mund të shqyrtohet në mënyrë komparative nga këndvështrimi i proceseve të radikalizmit që përfshijnë shoqëritë dhe shtetet në mes të krizës bashkëkohore të demokracisë liberale. Këto ngjarje dhe procese u zhvilluan brenda një gjeografie transnacionale më të gjerë të protestave dhe pretendimeve në fund të dekadës së parë të mijëvjeçarit të ri ... [Këto procese mund] të përforcojnë ‘politikën e mbylljes’ dhe të intensifikojnë reagimet e dhunshme konservatore-fobike në emër të mbrojtjes së homogjenitetit kombëtar ose komunal, vlerave dhe/ose rendit publik.

Për ta vënë këtë në kontekstin e Maqedonisë, është e mundur të kuptohet se si politika nacionaliste kapërceu synimet e dëshiruara të post-konfliktit të demokracisë liberale, duke lejuar kështu hapësirën për shfaqjen e linjave më radikale për brenda shoqërisë. Përderisa ky raport nuk është duke u përpjekur të argumentojë se qëndrimet politike dhe vendimmarrja janë shkaku kryesor i ekstremizmit në Maqedoni, ai nxjerr në pah argumentin se ky qëndrim ka krijuar një mjedis të përshtatshëm në të cilin mund të zhvillohen faktorët tematikë të Hafez dhe Mullins që çojnë në ekstremizëm të dhunshëm.

Apatia Institucionale dhe Mungesa e Besimit Publik si një Mjedis i Përshtatshëm

Analiza në terren ka treguar se ekziston një perceptim i përgjithshëm në mesin e të anketuarve lidhur me lidhjen midis vulnerabilitetit institucional dhe përhapjes së ekstremizmit brenda Maqedonisë. Përderisa pjesa më e madhe e këtij diskutimi ishte mbi institucionet dhe strukturat shtetërore, të anketuarit gjithashtu kritikuan Bashkësinë Fetare Islamike (BFI) dhe mediat për reagimet e tyre të pamjaftueshme ndaj përhapjes së ekstremizmit.

a) Institucionet shtetërore

Shumë nga pjesëmarrësit, një pjesë të fajit për përhapjen e ekstremizmit brenda Maqedonisë e vendosin në institucionet shtetërore dhe lokale për mungesën e interesit për t’u angazhuar me këtë temë dhe mungesën e mbështetjes për entitetet lokale që përpiqen të luftojnë këtë fenomen. Ky sentiment po ashtu u nda edhe kur erdhi çështja e kthimit të luftëtarëve të huaj, ku të anketuarit panë mungesë edhe në politikën edhe strukturën institucionale, për t’u marrë me këtë çështje aktuale.

Nga një këndvështrim lokal, një përfaqësues nga Zyra e Kryetarit të Komunës në Çair kritikoi mungesën e një organi të specializuar në nivel komunal për t’u marrë me kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, por gjithashtu theksoi se “mbi të gjitha ne nuk kemi ekspertizën [për të adresuar] këtë fenomen” (Zyra e Kryetarit të Çairit). Në mënyrë të ngjashme, në Gostivar, një përfaqësues nga Zyra e Kryetarit të Komunës njoftoi se një këshill komunal ishte themeluar për t’u angazhuar në çështjet që lidhen me ekstremizmin, por se “nuk punonte më për shkak të mosbesimit institucional” dhe tani më nuk ekziston një trup i tillë në komunë (Zyra e Kryetarit të Gostivarit). Përveç kësaj, grupi i fokusit prej 25-45 vjeç në Strugë tregoi se, në përvojën e tyre, madje edhe kur

ekzistonin institucionet, individët që kërkonin informacion në lidhje me kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm nuk kërkonin ndihmë nga institucionet e përmendura “si rezultat i faktit se besimi në institucione është shumë i ulët” (Struga FG 25-45).

Një çështje tjetër e ngritur nga të anketuarit ishte mungesa e njohjes nga institucionet e nivelit shtetëror lidhur me rrezikun që ekstremizmi i dhunshëm paraqet në kontekstin e Maqedonisë. Siç tregoi një OJQ nga Strugë, “institucionet shtetërore nuk janë ende të përgatitura për të parandaluar përhapjen e këtij fenomeni [...], madje deri kohët e fundit e kanë mohuar ekzistencën e kësaj çështjeje; ata nuk kanë një ide apo plan të qartë se si të kundërshtohet ky fenomen (OJQ 1 Strugë). Grupi i fokusit i Çairit prej 18-25 vjeç gjithashtu shfaqti këtë ndjenjë: “mungesa e interesit nga shteti është çështja kryesore” (Çair FG 18-25). Si e tillë, është e mundur të shihet se si mungesa e integritetit strukturor dhe parashikimit nga institucionet shtetërore dhe lokale në lidhje me kërcënimin ekstremist është problem sistematik.

Në përgjithësi, niveli i besimit të publikut në institucionet shtetërore është problematik. Në vitin 2013, 54% e maqedonasve etnikë besonin në qeverinë qendrore, ndërkohë që ky numër ishte vetëm 35% për shqiptarët etnikë. Sidoqoftë, sa i përket besimit në qeveritë lokale, hendeku midis besimit mes maqedonasve dhe shqiptarëve etnik në institucionet shtetërore bëhet shumë më i ngushtë – rreth 5%, në vend të 20% (Krzalovski 2013). Kjo sugjeron dy realitete, të cilat punojnë për të përforcuar narrativet e shfrytëzueshme të përjashtimit: se shqiptarët etnikë i besojnë liderët e tyre lokalë më shumë se sa që i besojnë qeverisë qendrore dhe se ekziston një marginalizim i perceptuar dhe/ose aktual i shqiptarëve etnikë në nivel kombëtar në Maqedoni.

b) Mediat

Ekzistonte një ndjenjë nga të anketuarit se, për mediat, kishte ngurrime për të folur ose për të raportuar mbi çështjet që lidhen me ekstremizmin nga frika e pasojave nga këto debate dhe diskutime. Siç theksoi përfaqësuesi i një mediumi nga Struga, “gazetarët këtu janë të frikësuar për të informuar apo për të folur për tema të caktuara”, dhe vuri në dukje mungesën e mekanizmave në nivelin shtetëror për të mbrojtur ata që angazhohen në debate rreth ekstremizmit (Struga Media). Për më tepër, Zyra e Kryetarit të Komunës së Gostivarit, tregoi se edhe kur ndodhin debate, ato shpesh janë të njëanshme dhe jo përfshirëse për të gjitha palët e interesuara: “Bashkëpunimi ndërmjet të gjithë aktorëve është kryesisht ceremonial; duhet të iniciohen debate mediatike ku përfaqësuesit fetarë do të marrin pjesë, por unë jam i mendimit se nuk ka vullnet të vërtetë në këtë drejtim”, (Zyra e Kryetarit të Komunës së Gostivarit). Si e tillë, është e mundur të shihet se në një nivel të gjerë shoqëror, ka mungesë angazhimi në çështjet që lidhen me ekstremizmin, dhe kur ekziston, nuk përfshihen të gjithë lojtarët. Mjedisi shoqëror si i tillë nuk lejon hapësirë për t’u angazhuar me këto çështje për shkak të natyrës së tyre “tabu”, e cila është e dëmshme për ata që përpiqen të kundërshtojnë narrativet e ekstremizmit.

c) BFI-ja

Ishte pikëpamja e shumë prej atyre që u intervistuan se BFI-ja ka mungesë të besimit publik dhe nuk ka autoritet të plotë mbi xhami të caktuara në Maqedoni, duke lejuar kështu hapësirë dhe mjedis të përshtatshëm për ngjalljen e narrativëve ekstremiste. Kjo ishte një çështje e vërejtur në të gjitha komunat, gjë që sugjeron që lindja e kësaj çështje rrjedh nga vetë BFI-ja, se sa nga komunitetet specifike në Maqedoni. Për më tepër, këto gjetje janë pasqyruar edhe në të dhënat burimore sekondare nga Qendra Maqedonase për Bashkëpunim Ndërkombëtar (2016): hulumtimet e tyre treguan se besimi i publikut në BFI ka rënë midis 2008 dhe 2016, nga 77% në 50%. Kjo periudhë gjithashtu pa një rritje të ndjeshme në luftëtarët e huaj nga Maqedonia dhe përhapjen e xhamive ekstremiste.

Të anketuarit nga grupi i fokusit të Gostivarit, prej 25-45 vjeçar, e theksuan qartazi këtë çështje, duke theksuar se “BFI-ja si institucion fetar ka dështuar [...] dhe nuk kanë besim nga popullata” (Gostivar FG 25-45). OJQ-ja me bazë në Çair, , artikuloi të njëjtin sentiment: “Problemi është se BFI-ja nuk dëshiron të pranojë se nuk kanë besim nga besimtarët, nuk kanë besueshmëri dhe integritet, veçanërisht në Çair” (Çair OJQ). Të intervistuarit nga grupi i fokusit (vetëm-femra) në Strugë shtuan më tej se BFI-ja nuk mund të ndërhyjë në punët e disa xhamive pasi ato “financohen nga jashtë dhe ndërtimi i këtyre xhamive është financuar nga këto fonde” (Struga FG Gra).

Për më tepër në këtë temë, një imam nga Gostivari theksoi se “nuk ka një departament në BFI që monitoron dhe kontrollon” xhamitë të cilat janë ndërtuar dhe financuar nga jashtë. Ai identifikoi se edhe imamët e këtyre xhamive janë shkolluar jashtë vendit për të predikuar në këto xhami, por se nuk ka asnjë mënyrë për të verifikuar se çfarë interpretimesh të Islamit ata predikojnë pas vendosjes së tyre brenda xhamive në Maqedoni. Më problematike, ai nënvizoi, ishte “importimi i ideve nga Arabia Saudite” që kanë marrë hovin pas mbërritjes së këtyre imamëve (Gostivar imam).

Gjatë bisedave me të anketuarit, pjesa më e madhe e kësaj mungese të besueshmërisë dhe integritetit duket se rrjedh nga përhapja e xhamive të paligjshme anembanë vendit, e njohur edhe si para xhemat⁹. Këto “xhami paralele” janë lejuar të dalin pranë institucioneve të ligjshme fetare, me sa duket brenda vakumit të pushtetit që mbetet pas një BFI-je joefektive. Përhapja e këtyre institucioneve ka lejuar përhapjen e njëkohshme të narrativëve ekstremiste që ata përkrahin, duke legjitimuar më tej narrativin e tyre dhe duke dobësuar narrativet e moderuara të përhapura nga xhamitë nën kontrollin e BFI-së. Për më tepër, legjitimimi i tillë i ka lejuar krijuesit e këtyre para xhemateve që “të vendosin gradualisht struktura paralele në fusha të tjera jetike, si në arsim, shërbimet sociale dhe kujdesin shëndetësor”, duke forcuar në këtë mënyrë strukturat paralele ekstremiste brenda shoqërisë më të gjerë. Këto para-xhemate gjenden kryesisht në zonën më të gjerë të Shkupit (veçanërisht në lagjet e Çairit dhe Sarajt) dhe drejtohen nga imamë ekstremistë të cilët shpesh ishin të arsimuar në programet Salafiste të sponsorizuara nga shtetet e Lindjes së Mesme (Qehaja dhe Perteshi 2018, 15)¹⁰.

Dy të anketuar në kuadër të grupit të fokusit vetëm-femra të kryera në Strugë, vunë në dukje kohëzgjatjen për të cilën para-xhematet kanë qenë një çështje e njohur për BFI-në. Të dy të anketuarit ishin më parë hulumtues në një OJQ lokale, të cilët gjatë punës së tyre biseduan me një numër imamësh të caktuar nga BFI-ja gjatë periudhës 2009-2013. Ata zbuluan se që nga viti 2009, BFI-ja ishte e vetëdijshme për përhapjen në rritje të para-xhemateve, por që BFI-ja kishte kërkuar nga imamët e saj të mos flisnin publikisht për këtë çështje. Në vlerësimin e tyre, ndërsa çështja ndërmjet viteve 2009 dhe 2013 ishte më problematike për shkak të mohimeve të BFI-së ndaj këtij fenomeni, kjo është një çështje që vazhdon të paraqesë probleme për të ardhmen (Struga FG Gra).

Hulumtimi i mëtejshëm sekondar përkrah pretendimet e të anketuarve në fokus grupin vetëm-femra të Strugës. Raportimi që nga viti 2010 tregon se para-xhematet ishin të njohura, por u injoruan nga BFI-ja, të cilët supozohet se me vetëdije u përpoqën të fshihnin praninë e këtyre xhamive me shpresën se ata do të zhdukeshin (shih Jovanovska dhe Gjorgjeski 2010). Për më tepër, siç dëshmohet edhe në punën e Qehaja dhe Pertesh (2018) mbi ekstremizmin në Maqedoni, BFI-ja nuk ishte vetëm e pasuksesshme në veprimin e saj si një zë i vetëm për të gjithë Muslimanët në Maqedoni, por gjithashtu ishte jashtëzakonisht e ngadalshme për të vepruar përballë problemit në rritje me para-xhematet.

Kjo mungesë e dukshme e kontrollit, administrimit dhe mbikëqyrjes nga ana e BFI-së në të gjitha tre komunat është tronditëse. Nëse BFI-ja ka për qëllim të jetë organi institucional që rregullon dhe menaxhon të gjitha xhamitë në Maqedoni, mungesa e tyre e kontrollit është lehtësisht e shfrytëzueshme nga predikuesit ekstremistë të cilët – për ata pjesëtarë të komunitetit Mysliman të cilët nuk janë në dijeni të çështjeve të perceptuara në udhëheqjen dhe kontrollin e BFI-së – mund t’u lejojë xhamive të udhëhequra nga ekstremistë të njëjtin respekt dhe besim si ato të drejtuara nga BFI-ja, duke u dhënë këtyre xhamive autoritet të barabartë.

Faktorët Arsimor

Faktorët arsimor për ekstremizmin e dhunshëm ndryshojnë në lloj: mungesa e arsimimit fetar cilësorë, mungesa e informacionit dhe aftësia e të menduarit kritik në mesin e popullatës në përgjithësi, dhe çështjet e lidhura me stafin mësimdhënës më gjerësisht. Përderisa secili nga këta faktorë, të paraqitur në vetvete, janë problematik si faktorë për ekstremizmin e dhunshëm, ata bëhen gjithnjë e më të përzier kur të tre janë të pranishëm në një skenar të caktuar. Për më tepër, faktorë edukativ janë vendosur brenda kësaj kategorie sipas kornizës së Hafez dhe Mullins, sepse nën një skenar funksional, sistemet arsimore duhet të ofrojnë struktura mbështetëse për ata që janë më të prekshëm ndaj thirrjes së ekstremizmit.

⁹ Për diskutim të mëtejshëm mbi para-jamaats, ju lutemi shihni: The Atlantic Initiative (2017), European Policy Centre (2017), Qehaja and Perteshi (2018), dhe Stojanović-Gajić (2018).

¹⁰ Për diskutim të mëtejshëm mbi para-jamaats, ju lutemi shihni: The Atlantic Initiative (2017), European Policy Centre (2017), Qehaja and Perteshi (2018), and Stojanović-Gajić (2018).

a) Deficiti në Edukimin Fetar

Nga më të përmendurat e këtyre çështjeve ishin mungesa e një edukimi fetar cilësorë – kjo u përshkrua si një edukim fetar me cilësi të dobët, ose një mungesë qasje në çfarëdo lloji edukimi fetar. Sipas të anketuarve, ky deficit në edukimin fetar krijon një boshllëk njohurish ku mund të lulëzojnë narrativet ekstremiste; për më tepër, pa një narrativ autoritar që ofron një interpretim jo-ekstremist të Islamit, nuk ka asnjë mënyrë për ata që kërkojnë njohuri fetare për të bërë dallimin mes pikëpamjeve të moderuara dhe ekstremiste. Cilësia, në këtë kuptim, ka kuptime të shumëfishta: ajo i referohet “disponueshmërisë” së edukimit fetar, nga pikëpamja gjeografike dhe gjinore; ajo është e parregulluar në aspektin e përmbajtjes, dhe; ajo nuk siguron lidhje midis shkrimeve fetare dhe nevojave të përditshme të Myslimanëve.

Në Çair, për shembull, kjo çështje u shtua edhe nga një mungesë e perceptuar e dëshirës nga një pjesë e popullatës për të kërkuar “të vërteta” fetare – domethënë, informacion për doktrinën fetare mbi Islamin – duke lejuar më tej hapësirë që narrativet ekstremiste të zënë vend. Përderisa individët nga grupi i fokusit në Gostivar, 25-45 vjeç, përmendën “moszbatimin e studimeve të duhura fetare në shkolla” (Gostivar FG 25-45), të anketuarit në Strugë, për më tepër, treguan mungesën e edukimit fetar në përgjithësi – qoftë ai të jetë Islami apo Ortodoksizmi – që reflekton mungesën në të gjithë hapësirën e Maqedonisë.

b) Deficitet në Mendimin Kritik

Pas kësaj, të anketuarit gjithashtu kritikuan cilësinë e arsimit në Maqedoni në përgjithësi. Sistemi arsimor, argumentojnë ata, i lë individët me një paaftësi për t’ju qas në mënyrë kritike informacionit që u është paraqitur atyre. Burimet sekondare janë gjithashtu treguese të kësaj gjetjeje dhe sugjerojnë që kjo çështje është bërë më thellësisht problematike në mesin e popullatave minoritare. Siç dëshmohet nga Fondacioni Evropian i Trajnimeve (2013, 13), ekzistojnë dëshmi të “diskriminimit të vazhdueshëm dhe përjashtimit të grupeve të vunerabël” siç janë shqiptarët etnikë për qasje të barabartë në arsim. Në mënyrë të ngjashme, në punën e tyre në pajtimin pas-konfliktit në Maqedoni, Popovska dhe Ristoska (2015, 63) theksojnë se “të menduarit kritik nuk është në agjendë në procesin arsimor dhe nga të rinjtë pritet më shumë të dëgjojnë sesa të mendojnë”.

Të intervistuarit e grupit të fokusit në Çair në demografinë 18-25 folën për këtë çështje duke deklaruar se “jo të gjithë janë pajisur me kapacitetin për të filtruar informacionin dhe për të menduar në mënyrë kritike” (Çair FG 18-25), ndërsa një individ i intervistuar nga një OJQ e Gostivarit vuri në dukje se individët kanë një “vështirësi dallimi” midis seteve të informatave (OJQ Gostivar 2). Më tej, të intervistuarit nga grupi i fokusit të grave në Strugë theksuan jo vetëm mungesën e aftësisë për të menduar në mënyrë kritike nga ata që përfshihen në ekstremizëm të dhunshëm, por edhe në strukturat e tyre mbështetëse – një i anketuar transmetoi historinë e një të riu që udhëtoi për në Siri për të luftuar, dhe prindërit e të cilit, me gjithë pikëpamjet e tyre jo-ekstremiste, interpretuan veprimin e tij si “të guximshëm”, sepse ata nuk ishin në gjendje të angazhoheshin në mënyrë kritike me pasojat afatgjate të veprimeve të tij (Çair FG 18-25).

Përderisa të anketuarit theksuan këtë deficit në aftësitë e të menduarit kritik, ata theksuan gjithashtu se kjo çështje u përforcua edhe nga mungesa e qasjes në informata lidhur me rreziqet e ekstremizmit. Kjo dukej se ishte veçanërisht problematike në kontekstin e Çairit, ku natyra e polarizuar e komunës ka ndikuar shumë. Një mësues i shkollës së mesme u shpreh se individët “janë të izoluar dhe ata kanë një mungesë të integritetit midis kombësive të ndryshme; ekziston mungesa e tolerancës fetare dhe kombëtare” e cila punon për të kompartmentalizuar narrativet dhe lë hapësirë të vogël për të diskutuar çështje që prekin komunitetin në tërësi. Për më tepër, të anketuarit theksuan mungesën e vullnetit për t’u angazhuar në një diskutim rreth rreziqeve të ekstremizmit në komunat e tyre. Zyra e Kryetarit të Komunës së Çairit ka theksuar se “komuniteti nuk është aspak i informuar për këtë fenomen – ka një mungesë të madhe të debateve lidhur me këtë temë” (Zyra e Kryetarit të Çairit). Më tej, OJQ me seli në Çair e përshkroi këtë fenomen si të tillë: “Nuk po ndodh asnjë debat. Ata nuk duan të pranojnë realitetin; ne nuk duam të flasim për zakonet e këqija në [Islam]” (Çair OJQ).

c) Mungesa e Mbështetjes Arsimore

Të anketuarit kanë identifikuar se mësuesit në shkolla nuk janë përgatitur në mënyrë adekuate për detyrën e edukimit të nxënësve për rreziqet që vijnë nga ekstremizmi i dhunshëm. Në rastin më të mirë, duket se tema e ekstremizmit të dhunshëm nuk diskutohet në nivelin e stafit shkollor për shkak të natyrës së tij komplekse dhe delikate dhe se strukturat shkollore nuk lejojnë që këto narrative të adresohen në një mënyrë të gjerë dhe efektive. Deri më sot, shmangia dhe mos angazhimi ka qenë strategjia e ndërmarrë nga shkollat, gjë e cila vazhdon të jetë e dëmshme për ata që janë më të ndjeshëm ndaj thirrjes së ekstremizmit të dhunshëm.

Të intervistuarit në Strugë duket se ishin më të zëshmit në lidhje me këtë çështje. Një arsimtar i shkollës së mesme u ankua se “ne nuk priremi për të folur me nxënësit tanë lidhur me këto çështje”, dhe theksoi “mendoj se arsimi duhet të luajë një rol të madh këtu duke pasur parasysh [afërsinë e Strugës] me Shqipërinë” (profesor i shkollës së mesme në Strugë). Zyra e Kryetarit të Komunës në Strugë gjithashtu preku çështjen e përkatësisë etnike, duke kritikuar gjithashtu qasjet e institucioneve arsimore në këtë temë, duke theksuar se “në disa shkolla, për të shmangur tensionet ose konfliktet ndëretnike, orari i nxënësve është i ndarë” (Strugë Zyra e Kryetarit të Komunës).

Ky lloj i ndarjes, veçanërisht në lidhje me nevojën për edukimin mbi ekstremizmin e dhunshëm brenda kontekstit shkollor, shkakton polarizim të mëtejshëm dhe më pak vullnet në emër të mësimdhënësve për të adresuar këto çështje. OJQ e Strugës ka tentuar të angazhohet me profesorët për të ndihmuar në nxitjen e këtij dialogu në shkolla, por pa sukses - “ka pasur shumë iniciativa në kuadër të projekteve të ndryshme për të formuar grupe që do të thyenin këtë mungesë komunikimi, por jeta e tyre nuk ishte e gjatë”. Si i tillë, edhe kur ofrohet bashkëpunimi në këtë fushë, ekziston hezitimi nga profesorë për të gjetur hapësirë për këto diskutime në nivel institucional.

Për më tepër, çështja e ekstremizmit të bazuar tek mësimdhënësit duhet të diskutohet gjithashtu. Brenda kontekstit të Çairit, të intervistuarit nga grupi i fokusit gjithë-femëror përshkruan raste në përvojat e tyre në shkollë ku mësimdhënësit demonstrojnë shenja të ekstremizmit. Për shembull, një e anketuar transmetoi një përvojë ku ajo zbuloi se një mësimdhënësi po drejtonte rituale të paautorizuara të lutjes brenda bibliotekës së shkollës; dhe edhe pse drejtori i shkollës ishte informuar, asgjë nuk ishte bërë. Përderisa “i paautorizuar” nuk nënkupton automatikisht “ekstremist”, shfaqja e aktiviteteve të tilla demonstroi se aktivitetet me vija fetare ndodhin dhe ngelen të pa-sanksionuara, administratohen nga individë të emëruar në pozita dhe ngelen të pa njohuara për shoqërinë e zakonit. Një tjetër e anketuar nga grupi ndau një përvojë të një mësimdhënësi të matematikës në shkollën e saj, i cili u kushtonte një orë në ditë mësimëve fetare ekstremiste duke anashkaluar detyrimet e tij sipas programit mësimor të matematikës, në të cilën nxënësit “grykoheshin publikisht për veshjet e tyre të jo-modeste” dhe mësonin për interpretime ekstreme të parimeve fetare Islamike. Përsëri, megjithatë, asgjë nuk u bë kur kjo çështje u ngrit me autoritetet e shkollës (Çair FG Gra). Këto janë shembuj kritikë – mungesa e mbështetjes arsimore nuk është vetëm diçka që përjetohet në nivelin e mësimdhënës-nxënës, por edhe në nivelin e institucioneve të arsimit dhe nxënësit, duke i lënë nxënësit të vuajnë shumë pika të dështimit.

d) Vulnerabilitetet Arsimore në Bazë Gjinore

Një gjetje e dukshme nga puna në terren në këtë fushë ishte aspekti gjinor i çështjes së vulnerabilitetit (cenueshmërisë) arsimore. Të intervistuarit nga grupi i fokusit gjithë-femëror i zhvilluar në Strugë shprehën se, në përvojën e tyre, gratë etnike shqiptare në zonat rurale kishin më pak qasje në arsim dhe kështu kishin aftësi të pazhvilluara të të menduarit kritik, pasi normat shoqërore në këto zona nuk i japin rëndësi të konsiderueshme edukimit femëror. Për më tepër, ato nuk janë në pozitë për të qenë në gjendje të përmirësojnë situatën e tyre:

[Gratë] nuk kanë asnjë lloj të drejte brenda familjeve të tyre dhe shoqërisë, ato janë të diskriminuara, e drejta e tyre e vetme është të lindin dhe të rritin fëmijët e tyre, ato vetëm dëgjojnë atë që thonë të tjerët (Struga FG Gra).

Grupet e fokusit në Çair, 18-25 vjeç, artikuluan sentimente të ngjashme: “Ne nuk na intereson edukimi i një gruaje si një proces primar dhe i rëndësishëm për të ndërmarrë gjatë jetës së saj ... na intereson më shumë për dhuratat që ajo do t’u japë njerëzve kur ajo të martohet “(Çair FG 18-25). Në këtë mënyrë, fuqizimi i femrave shuhet nga një moshë e re, pasi vajzave nuk u sigurohet e njëjta hapësira politike dhe sociale si meshkujve brenda komunitetit etnik shqiptar. Megjithatë një gjetje

më e vogël midis të intervistuarve përmes punës në terren, është e rëndësishme të theksohet se në Maqedoni ka hapësirë për qasje gjinore për të parandaluar dhe për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm, të cilat do të marrin parasysh disa nga këto realitete rurale të gjinive.

3.2.2 Ideologjitë Ekstreme, Rrjetet dhe Lidhjet Ndër-personale

Ndikimi Ideologjik dhe Afërsia (Proksimiteti) Ideologjike

Në këtë kontekst, “Afërsia (proksimiteti) ideologjike” i referohet lehtësisë me të cilën një individ mund të ketë qasje në materiale, individë dhe pikëpamje ekstremiste, si nga pikëpamja fizike ashtu edhe nga pikëpamja kohore. Gjetjet në terren e demonstrojnë këtë fenomen në mënyra të shumta, të ndërlydhura mes veti.

Sipas të gjeturave në të tri komunat, kishte një ndjenjë nga të anketuarit se disponueshmëria e gjerë e materialeve ekstremiste në internet – më së shumti e përhapur përmes mediave sociale – padyshim se e ka lehtësuar procesin e radikalizimit dhe rekrutimit në grupe ekstremiste. Një përfaqësues i OJQ-së, i intervistuar në Gostivar, theksoi se përhapja e materialeve ekstremiste në internet i dha përmbajtjes së tyre, një lloj vlefshmërie të shtuar për shkak të lehtësisë së kërkimeve, dhe cilësisë së lartë të produktit mediatik, duke i lënë individët më pak të përrur për të kritikuar informacionin që gjendet aty (OJQ Gostivar 1). Sa i përket asaj që u tha më lartë, ky lloj i qasjes së stilizuar për produktet mediatike ka qenë shenjë dalluese e strategjisë mediatike të ISIL-it, ku është e mundur të shihet kjo ndërhyrje ekzakte në punë (shih Ingram 2016). Prandaj, ideja e “afërsisë” e ndikimit ideologjik është bërë më e vogël nëpërmjet lidhjes elektronike. Përderisa Maqedonia mund të jetë një vend i vogël si në madhësi ashtu edhe në popullsi, lehtësia e qasjes në materiale ekstremiste online e bën këtë ndikim ideologjik shumë më afër dhe, ndoshta paradoksalisht, më global në fushën e veprimtimit. Të intervistuarit nga të gjitha komunat vunë në dukje këtë fenomen të afërsisë ideologjike, si lokale ashtu edhe globale.

Përveç kësaj, mediat sociale mund të përdoren si vegla për të targetuar individët që mund të perceptohen si të hapur ndaj narrativëve ekstremiste. Të intervistuarit në Gostivar thane se kjo është një çështje e veçantë në komunitetin e tyre krahasuar me komunat e tjera. Një imam në Gostivar e përshkroi këtë si “ndjekje të verbër dhe shfrytëzim të dobësisë” nga rekrutuesit (Gostivar Imam), dhe përfaqësuesi i OJQ-së i intervistuar theksoi se rekrutuesit përdornin izolimin e njerëzve nga shoqëria më e gjerë, duke shfrytëzuar këtë, dhe duke e pozicionuar ideologjinë e tyre ekstremiste si shumë inkluzive (OJQ Gostivar 1). Përveç kësaj, platformat e mediave sociale janë përdorur për të zhduruar zërat e moderuar të cilët përpiqen të largojnë narrativet ekstremiste. Siç shpjegoi një përfaqësues i medias në Strugë, ai “po përpiquej të jepte një informacion më të balancuar” përmes platformave online, por “kërcënohej nga njerëz anonim në rrjetet sociale” për shkak të pikëpamjeve të tij të moderuara (Struga Media).

Afërsia ideologjike, megjithatë, nuk shfaqet thjesht në platformat online; përkundrazi, afërsia ndaj ligjëratave ekstreme, predikuesit dhe xhamitë kishin efektin e ‘përhapjes’ të materialit ekstremist jofizik, siç është “materiali” i shpërndarë me gojë nëpërmjet leksioneve, predikuesve dhe xhamive. Kjo është vërejtur si një pikë e veçantë shqetësuese në kontekstin e Çairit midis të intervistuarve, veçanërisht në mesin e xhamive që nuk ishin të kontrolluara nga BFI-ja. Të intervistuarit nga grupi i fokusit gjithë-femëror në Çair vunë në dukje se xhamia e Abdyl Kadrit është e njohur për ligjëratat e saj ekstremiste që përdorin “retorikë ekstreme shpirtërore” dhe nuk i tremben “thirrjeve të hapura për t’u bashkuar me grupet ekstremiste” (FG Çair Vajza 2). Grupi gjithashtu vuri në dukje se xhamia ka një prapavijë të dyshimtë, pasi nuk dihet fare rreth saj dhe burimi i saj i financimit është i zhytur në mister (FG Çair Vajza 2).

Në mënyrë problematike, dëshmitë sugjerojnë se xhamia e Abdyl Kadrit nuk është e vetmja xhami e tillë në komunë. Për shembull, xhamitë Tutunsuz dhe Jahja Pasha, janë vende ku imami famëkeq Rexhep Memishi – i pranuar gjerësisht si rekrutuesi më i madh i luftëtarëve të huaj në Maqedoni, para burgimit të tij – operacionet e tij i kishte të bazuara në Çair. Në studimin e saj mbi fenomenin e luftëtarëve të huaj në Maqedoni, Iniciativa Atlantike (2017, 106) vuri në dukje se shumë luftëtarë të huaj që dëlnin nga komuna e Çairit “e njihnin njëri tjetrin dhe që ishin ndikuar dhe rekrutuar në të njëjtën mënyrë”, nga Memishi në këto xhami. Puna e kryer në terren në kuadër të këtij raporti gjeti dëshmi të ngjashme për Çairin, me një të anketuar që sugjeroi se “nuk ka asnjë person

i cili nuk është prekur nga ekstremizmi në Çair”, veçanërisht ata që u rritën në grupe të ngjashme miqësore dhe lagje (Çair FG Gra).

Për më tepër, siç ka shënuar Hafez (2016, 15), përhapja ideologjike e ekstremizmit midis grupeve të miqve ka çuar në krijimin e socializimit radikal dhe formimin e rrjeteve ekstremiste:

Lidhjet e ngushta dhe miqësore ofrojnë mundësi për një socializim radikal, që në të njëjtën kohë i plotësojnë nevojat psikologjike, si shmangia e disonancës kognitive, nevojën për të mbajtur marrëdhënie kuptimplote dhe validimin nga bashkëmoshatarët e vlerësuar [...] lidhjet familjare dhe miqësore mund të transpozojnë angazhime radikale politike dhe këto angazhime, nga ana tjetër, intensifikojnë lidhjet e besnikërisë midis të afërmeve dhe miqve.

Si në Çair dhe Gostivar, të anketuarit e grupeve të fokusit vunë në dukje individët që ata kishin njohur në mënyrë indirekte, të cilët kishin shmangur rrjetet e tyre të mëparshme të miqve dhe të familjes për një socializim më të madh ekstremist, dhe vënë në dukje se kjo ishte një nga hapat e tyre të parë në rrugën e radikalizimit të dhunshëm. Proksimiteti, në këtë kuptim, është qasja gjeografike – fizike ndaj predikuesve ekstremistë dhe sferat e tyre të ndikimit shkaktojnë një lloj socializimi ekstremist, në të cilin individët janë bërë, paradoksalisht, gjithnjë e më të huaj nga miqtë e tyre të mëparshëm dhe më pas socializohen me të shokë të mendimeve të njëjta ekstremiste në një rrjet më të gjerë të ekstremizmit.

Deficiti në Kohezionin Familjar

Në tërësi, në të tri komunat, të anketuarit kanë identifikuar se prindërit luajnë një rol kritik në artikullimin e interpretimeve jo-ekstremiste të Islamit, dhe duke larguar disa nga narrativet e gjetura në pikëpamjet ekstremiste. Të anketuarit vunë në dukje lidhjen mes zonave kritike të të kuptuarit në fëmijëri dhe dobësitë drejt narrativave ekstremiste më vonë në jetë. Për shembull, kur diskutonin këtë gjetje me grupin e fokusit në Çair, të përbërë nga 18 deri në 25 vjeç, lidhja familjare u bë akute. Siç tha një i anketuar, “nuk kemi pasur rastin të kuptojmë së pari konceptin bazë të fesë në mënyrë që të zgjedhim më vonë nëse dëshirojmë të jemi pjesë e saj ose jo. Unë mendoj se të rinjtë ende nuk e dinë pse ata janë Myslimanë apo pse ata luten – ata vetëm e bëjnë këtë” (Çair FG 18-25).

Të anketuarit në Strugë folën për këtë fenomen po ashtu. Një i anketuar i cili ishte pjesë e grupit të fokusit të Strugës me individë nga 25 deri në 45 vjeç, përshkroi një histori që përfshinte një nxënës që ishte kapur duke parë materiale ekstremiste në internet në shkollë; mësuesi i nxënësit disa herë u përpoq të takohej me babanë e tij, por pa sukses (Struga FG 25-45). Ky shembull flet jo vetëm për nevojën që figurat e prindërve të përfshihen në edukimin fetar, por edhe për nevojën për t’u angazhuar në një dialog të vazhdueshëm me fëmijët e tyre lidhur me ekstremizmin, veçanërisht në rastet kur mësuesi kërkon mbështetje nga figurat e prindërve në luftimin e radikalizimit.

3.2.3 Pakënaqësitë Kolektive dhe Personale

Izolimi, Alienimi dhe Margjinalizimi si Narrativë i pakënaqësive

Në të tri komunat e studiuara, një ndjenjë izolimi, alienimi ose margjinalizimi u përkufizua si një narrativë i shfrytëzueshëm i pakënaqësive, në të cilin individët që kërkonin të ishin pjesë e një qëllim ose grupi më të lartë ishin më të prekshëm. Kjo pakënaqësi individuale është në kundërshtim me një shoqëri më të gjerë, e cila është përgjegjëse për ndjenjën e izolimit, alienimit ose margjinalizimit të një individi vulnerabil.

Në mënyrë kritike, ekziston një pike kyçe brenda formimit të narrativeve të pakënaqësive, ku pakënaqësitë personale i plotësojnë pakënaqësitë kolektive. Aspekti social i ekstremizmit është kritik në këtë drejtim, atje ku margjinalizimi krijon një nevojë ekstreme për përkatësi; kjo manifestohet në konceptin e “grupit” ose “vëllazërisë”, ku narrativet e përgjithshme globale të përjashtimit dhe përfshirjes janë në lojë në të njëjtën kohë. Sipas Mahood dhe Rane (2017, 18), kjo ndjenjë e përjashtimit dhe dëshirës për përkatësi janë të bashkë-prirura nga narrativet ekstremiste, të cilët e paraqesin

umanë (umma) si aleancën përfundimtare për Muslimanët; pra:

[...] ndjenja e pakënaqësisë që evokohet në lidhje me vuajtjet e Myslimaneve në mbarë botën drejtpërsëdrejti për shkak të politikave të qeverive perëndimore ose në mënyrë indirekte për shkak të sundimtarëve Myslimanë të cilët ata i mbështesin. Kjo ndjenjë e pakënaqësisë në përgjithësi nuk është pasojë e përvojës personale por e nxitur nga narrativet e opresionit ndaj Myslimaneve.

Rekrutuesit pastaj e arsyetojnë këtë pjesëmarrje dhe përkushtim ndaj umasë (umma) me një lloj obligimi moral për veprim drejt mbrojtjes së saj duke treguar rëndësinë e “korrigjimit të padrejtësisë që u ishte shkaktuar popullit Mysliman në nivel lokal dhe global” (OJQ Çair). Ky lloj i eksploatimit të ankesave është ajo që Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID 2009, 16) i referohet si “pakënaqësitë globale”, në të cilin çështjet globale ndërthuren me detyrimet dhe realitetet lokale.

Brenda kontekstit të Maqedonisë, ky narrativ i pakënaqësive duhet gjithashtu të kuptohet brenda kontekstit të post-Konfliktit të Armatosur, si dhe brenda dekadave të përjashtimit dhe shtypjeve që çuan në të, dhe perceptimit të ndjenjës së humbjes tek maqedonasit etnikë. Si e tillë, dhuna e perceptuar e targetuar ndaj popullsisë shqiptare etnike, siç paraqitet nga ata që përhapin narrative ekstremiste, “përdoret brenda narrativeve të rekrutimit [...] të viktimizimit që mbështetet nga realitetet e mbetura të post-konfliktit” (Ruge 2017). Përderisa një individ shqiptar etnik mund të ndjejë ndjenjën e izolimit, tjetërsimit ose marginalizimit nga shoqëria e gjerë në Maqedoni, pakënaqësitë e tyre mbivendosen në narrativet më të përgjithshme, narrative të pakënaqësive kolektive të popullatës etnike shqiptare, siç definohej nga narrativet ideologjike ekstremiste.

Kjo dëshirë e përkatësisë brenda kontekstit të komunave u përshkrua si një vullnet emocional, në të cilin narrativet ekstremiste u ofruan atyre që ishin të prekshëm ndaj ekstremizmit me mundësinë për të gjetur domethënie më të gjerë përtej vetes së tyre. Për shumicën, interpretimet ekstremiste të Islamit iu drejtuan pakënaqësive ndaj izolimit, alienimit dhe marginalizimit që ata kishin ndaj një shoqërie më të gjerë, dhe krijuan një ndjenjë përkatësie – një komunitet ideologjik i bazuar në aderimin e rreptë dhe ekstrem të religjionit, ku identiteti i individit ishte në gjendje të zëvendësohet në rëndësinë dhe detyrimin moral nga ideja më e madhe e umasë (umma).

Analiza nga puna në terren është po ashtu në përputhje me hulumtimet dytësore. USAID-i ka identifikuar se “në shumë raste, ajo që sjell ekstremistët e dhunshëm së bashku është përkushtimi i tyre i përbashkët për një vizion të veçantë se si shoqëria duhet të organizohet dhe/ose dyshimet e tyre të forta mbi themelet mbi të cilat shoqëritë e tyre aktualisht janë të organizuara” (USAID 2009, 12). Në këtë mënyrë, ofrimi i narrativëve ekstremiste si zgjidhje për izolimin, alienimin dhe marginalizimin në kontekstin e Maqedonisë mundësuan përforcimin e vazhdueshëm të narracionit të bazuara në ideologji, të cilat punojnë për të luftuar ndjenjat e izolimit social dhe politik për ata që kërkojnë kuptim dhe qëllim përtej vetes së tyre individuale.

Banorët në Çair shprehën se një ndjenjë izolimi, alienimi ose marginalizimi – e perceptuar ose jo – ishte një veçori këmbëngulëse dhe e vazhdueshme në dinamikën e komunitetit të tyre. Për shembull, grupi i fokusit gjithë-femëror që u zhvillua atje, vuri në dukje se Çairi vuan nga shumë forma të ekstremizmit – qoftë Islamik ose nacionalist – dhe se banorët e tij jetojnë në një lloj fërkimi me njëri-tjetrin, ku ekstremizmi politik është thellësisht i lidhur me ideologjinë dhe ekstremizmit fetar. Ata vunë në dukje se ky fërkim është një lloj polarizimi mes banorëve, duke lënë pak hapësirë në mes për diskutime kritike nga frika e polarizimit të mëtejshëm të komunitetit. Për më tepër, në vlerësimin e tyre, Çairi ishte një lloj “pikë strategjike politike” e cila historikisht është “keqpërdorur politikisht” dhe, si e tillë, individët që jetojnë atje janë “të marginalizuar dhe të gjykuar” nga ata që jetojnë në vende tjera në Shkup (Çair FG Gra). Në këtë mënyrë, individët e këtij komuniteti në mënyrë efektive grupohen, ose socializohen, në grupe ekstreme në të dyja anët e spektrit. Nga një pikëpamje e formimit narrativ të pakënaqësive, OJQ-ja me seli në Çair, e përshkroi këtë fenomen si një mundësi për individët “për të vendosur statusin e tyre në shoqëri, në kuptimin që ata do të jenë pjesë e një grupi elitari që ndajnë pikëpamje të ngjashme”.

Të anketuarit në Gostivar gjithashtu vunë në dukje se një ndjenjë izolimi, alienimi ose marginalizimi luajti rol në rekrutimin ekstremist në komunën e tyre. Megjithatë, ka pasur një ndjenjë në mesin e shumë të anketuarve që demografia e moshës luajti një rol në përcaktimin e vulnerabilitetit të një individi për këtë lloj nxitje. Si grupi i fokusit ashtu edhe një OJQ theksuan se individët më të

rinj në adoleshencë ose në të njëzetat e hershme ishin më të prekshëm ndaj ndjenjave të izolimit, pasi kjo kohë në jetën e tyre u bazua në rëndësinë e dinamikës së grupit dhe në dëshirën për përkatësi. Në veçanti, rekrutuesit ekstremistë e shfrytëzuan “viktimizimin dhe margjinalizimin e grupeve të caktuara” (Gostivar Mësues) dhe kërkonin individë që “e shohin veten ndryshe nga të tjerët” dhe që ndjenin “një pamundësi për të shprehur idetë e tyre në vendin e tyre ose në mjedisin e tyre” (OJQ Gostivar). Në këtë mënyrë, narrativet ekstremiste ofrojnë një identitet për ata që nuk ndihen të asocuar në shoqëri, dhe socializimi i tyre me individë me ide të njëjta ndihmon për të përhapur, ndërtaur dhe legjitimuar këto narrative.

Krahasuar me Gostivarin dhe Çairin, Struga dukej se ishte më e veçantë në mesin e komunave të studiuara, për aq sa izolimi mes grupeve të pakicave nuk ishte sistemik, por periodik. Është vërtet se izolimi si nxitës i socializimit ekstremist ishte më i dukshëm gjatë periudhave zgjedhore. Në vitet e fundit në kontekstin e Maqedonisë, periudhat e zgjedhjeve janë përcaktuar nga rrëmbimi i narrativave etnike nga disa parti në mbështetje të agjendave të tyre politike. Nxitja e nacionalizmit si mes votuesve etnik maqedonas ashtu edhe mes dhe atyre etnik shqiptarë, pa dyshim ndikon në sasinë e kapitalit politik që u jepet narrativeve ekstremiste, duke lënë kështu pak hapësirë për dialog të moderuar gjatë këtyre periudhave. Siç vuri në dukje një nga të anketuarit e OJQ-sënë Strugë, “ekstremet e mos-pranimi të multikulturalizmit arrihen në periudhën e fushatave zgjedhore” (OJQ Struga 1). OJQ elaboroi më tej në këtë pikë: “është e dukshme urrejtja, ndjenja e solidaritetit nuk është shumë e zhvilluar në mesin e komunitetit” (OJQ Struga 2). Në këtë mënyrë, polarizimi i bashkësive multi-etnike normalizohet dhe politika e identitetit – e bazuar në një kuptim më të gjerë të përkatësisë etnike – manifestohet në mënyrë ekstreme.

Pakënaqësitë Ekonomike

Maqedonia aktualisht vuan nga një shkallë e lartë e papunësisë që rrjedh nga një klimë ekonomike e dobët, e cila aktualisht qëndron në 22 përqind – dhe arrin në 55 përqind në demografinë e të rinjve (CEIC 2018; Fondacioni Evropian i Trajnimit 2013, 8). Statistikat krahasuese në lidhje me gjendjen ekonomike të shqiptarëve etnikë kundrejt maqedonasve etnikë në Maqedoni (për shembull normat e punësimit, pagat mesatare, të ardhurat e disponueshme etj.) për fat të keq nuk janë në dispozicion. Kjo me siguri do të ishte një fushë për hulumtimet e ardhshme, si një ekzaminim i krahasimeve të përgjithshme ekonomike midis dy grupeve, si dhe një fushë kërkimi që ka një marrëdhënie me ekstremizmin, siç tregohet anekdotikisht nga hulumtimi i këtij raporti.

Megjithëse nuk paraqitet si një narrativ parësor i pakënaqësive që asocohet me ekstremizmin e dhunshëm, shumë nga të intervistuarit vunë në dukje se motivimet financiare të bazuara në klimën e dobët ekonomike të Maqedonisë ishin një nxitës potencial drejt aktivitetit të ekstremizmit të dhunshëm. Megjithatë, është po aq e rëndësishme të theksohet se të anketuarit nga një komunë – Strugë – treguan se një motivim financiar drejt aktivitetit ekstremist ishte i papërfillshëm në kontekstin e tyre dhe ishte më tepër një shtojcë ndaj nxitësve të tjerë më të përhapur ndaj ekstremizmit të dhunshëm.

Të anketuarit në Gostivar dhe Çair duket se janë në të njëjtën linjë në lidhje me potencialin e pakënaqësive ekonomike që luajnë një rol të rëndësishëm në komunën e tyre. Një mësues në Gostivar sugjeroi që të rinjtë ishin veçanërisht në rrezik përballë stimujve financiarë si një nxitës i mundshëm, duke pasur parasysh gjendjen ekonomike me të cilën përballen ata në Maqedoni (Gostivar Mësues). Të intervistuarit në Çair u ndjenë ngjashëm: në grupin e fokusit të kryer me moshën 18-25 vjeç, të anketuarit sugjeruan se “një i ri për t’u indoktrinuuar është mjaft e lehtë, veçanërisht kur vijnë nga shtresat më të ulëta të shoqërisë ku ata përballen me probleme financiare – ata gjejnë [stimuj financiarë në përgjigje të pakënaqësive të tyre ekonomike] si një zgjidhje dhe një mbështetje” (Çair FG 18-25). Megjithatë, të anketuarit nga një OJQ religjioze nuk u pajtuan me këto pikëpamje (Çair OJQ 2).

Të anketuarit në Strugë ishin më pak të prirur për të parë ankesat ekonomike si nxitës të mundshëm drejt ekstremizmit brenda kontekstit të komunës së tyre. Siç shprehet një përfaqësues i medias, “Unë nuk mendoj se faktori ekonomik është me ndikim, sepse njerëzit këtu, kur kanë probleme financiare, vendosin të shkojnë në vendet perëndimore për të punuar dhe për të gjetur zgjidhje” (Struga Media). Të anketuarit e tjerë nga Struga shfaqën mendime tjera, duke theksuar se ishte e mundur që motivi financiar të ishin një nxitës, megjithëse nuk kishin prova konkrete për të mbështetur këto pretendime. I vetmi përjashtim në këtë drejtim ishte grupi gjithë-femëror në Strugë,

i cili kishte dëgjuar raste të disa familjeve në Strugë që pranonin \$ 300- \$ 500 USD për t'u bashkuar me grupet ekstremiste. Si i tillë, përderisa është e mundur që motivimet financiare mund të jenë një nxitës në ekstremizmin e dhunshëm në Strugë, aktualisht nuk ka indikacione se ai luan një rol të rëndësishëm.

3.3 Faktorët e qëndrueshmërisë (Reziliencës)

Si pjesë e punës në terren, të anketuarve u kërkuan gjithashtu që të identifikojnë se ku ekzistojnë burimet e qëndrueshmërisë (reziliencës) brenda komunave përkatëse – duke përfshirë cilëndo iniciativë, program ose qasje komunale – si dhe ku mund të krijohet hapësirë në të ardhmen që faktorët e qëndrueshmërisë të nxiten në komunat e tyre. Këto gjetje janë grupuar në fusha tematike, të artikuluar me gjetjet e secilës komunë përbrenda.

3.3.1 Multikulturalizmi

Në të gjitha komunat, të intervistuarit potencuan nevojën dhe praninë e projekteve që theksojnë rëndësinë e diversitetit dhe respektit në një shoqëri multietnike. Megjithatë, ka pasur një ndryshim të konsiderueshme mes komunave lidhur me atë se si është përmbushur kjo nevojë, dhe nëse ka pasur në përgjithësi.

Të anketuarit e Çairit theksuan se është duke u bërë shumë pak brenda komunitetit të tyre për të nxitur narrative pozitive në lidhje me diversitetin – në veçanti, si të bashkëjetojnë në mënyrë paqësore mes grupeve të ndryshme etno-fetare – gjë që ishte shqetësuese për të anketuarit duke pasur parasysh natyrën shumetnike të komunës së Çairit. Në disa raste, të anketuarit vunë re se kishte një ndjenjë të rezistencës midis anëtarëve të caktuar të komunitetit për t'u angazhuar në linjat multi-etnike. Për shembull, grupi i fokusit gjithë-femëror identifikoi se fëmijët e moshës shkollore shpesh largoheshin nga leximi i librave nga autorët e një prejardhje tjetër fetare nga ajo e tyre, dhe se ishte e zakonshme që nxënësit të ndaheshin në linjat etno-fetare, duke e ndarë veten fizikisht nga grupet e moshatarëve të tyre (Çair FG Vajza 2). Për të adresuar këto boshllëqe, të anketuarit e Çairit theksuan rëndësinë e prezantimit të projekteve dhe aktiviteteve arsimore me kosto të lirë ose pa pagesë që do t'u lejonin të rinjve të angazhohen me individë nga prejardhje të ndryshme kulturore, kombëtare dhe fetare, si dhe duke ndarë kohë gjatë orarit të mësimin për t'u përqendruar në çështjet që lidhen me integrimin.

Individët në Gostivar dhe Strugë iu përgjigjën më pozitivisht temës së multikulturalizmit në lidhje me qasjet që komunat e tyre kanë marrë dhe vunë në dukje se këto iniciativa kanë ndikuar në qëndrueshmërinë e komunave të tyre. Të anketuarit nga grupi i fokusit 18-25 vjeçar në Gostivar, identifikuan se individët në moshën demografike të tyre ishin “të informuar mirë dhe praktikojnë vlerat e multikulturalizmit, tolerancës dhe solidaritetit në jetën e përditshme” (Gostivar FG 18-25). Një i anketuar nga Zyra e Kryetarit të Komunës së Gostivarit po ashtu i pohoi këto sentimente, duke theksuar se Këshilli Rinor i Gostivarit është arkitekti kryesor i ngjarjeve dhe festivaleve multi-etnike në komunë (Zyra e Kryetarit të Komunës së Gostivarit). Grupi i fokusit i lartpërmendur gjithashtu pohoi se individët në komunitet kenë një nivel bazë të respektit për njerëzit me prejardhje të ndryshme etno-fetare dhe se ka një liri asociimi, e cila tejkalon linjat etno-fetare (Gostivar FG 18-25).

Megjithatë, disa nga të anketuarit në Gostivar përsëritën se mund të bëhej më shumë për të ndihmuar në promovimin e diversitetit dhe, në veçanti, zbatimin e programeve arsimore për t'i ndihmuar individët të identifikojnë lidhjet midis intolerancës etno-fetare dhe ekstremizmit (Gostivar FG gra). Në mënyrë të ngjashme, përderisa i anketuari nga Zyra e Kryetarit të Komunës vlerësoi përpjekjet e Këshillit Rinor, ata vunë në dukje se, përveç përpjekjeve të tyre, projektet multi-etnike në përgjithësi “nuk kanë qenë të shumta” (Zyra e Kryetarit të Komunës së Gostivarit).

Të anketuarit në Strugë gjithashtu theksuan gjetje të ngjashme me homologët e Gostivarit, megjithëse me disa dallime të dukshme. Një përfaqësues i OJQ-ve në Strugë ka artikuluar se individët brenda komunës së Strugës në përgjithësi e përqafojnë promovimin e bashkëjetesës midis grupeve të ndryshme në shoqëri. Për shembull, për të ndihmuar në këtë përpjekje, OJQ-ja organizon udhëtime për të rinjtë në një sërë lokacionesh të ndryshme në mënyrë që ata të mund të mësojnë

dhe të ndërveprojnë me individë jashtë sfondit të tyre etno-fetar; të rinjtë në veçanti janë vënë në shënjestër në këtë mënyrë pasi OJQ-ja beson se ata janë më të ndjeshëm ndaj mesazheve ekstremiste dhe kështu i përdorin këto iniciativa për të ndihmuar në parandalimin e këtij fenomeni. Për më tepër, OJQ-të në Strugë luajtën një rol kyç në organizimin e ngjarjeve multikulturore. Siç theksoi një i intervistuar, OJQ-të “luajnë një rol të madh në organizimin e aktiviteteve të ndryshme për të rritur ndërgjegjësimin për ekstremizmin e dhunshëm [...] shumë nga këto të implementuara edhe në mungesë të aktiviteteve dhe objekteve rekreative në Strugë”, duke nxjerrë në pah rëndësinë e këtyre aktorëve përballë një mungese të iniciativave komunale.

Pas kësaj, të gjithë të anketuarit nga Struga argumentuan se përderisa individë brenda qytetit të Strugës ishin më pak të ndjeshëm ndaj narrativeve ekstremiste, kjo nuk ishte e tillë për fshatrat brenda komunës. Në përgjithësi, të intervistuarit e përshkruan Strugën si “më liberale” krahasuar me fshatrat kryesisht shqiptarë etnike që e rrethonin atë dhe më pak të prirur drejt religjionit; sipas pikëpamjes së tyre, ky laicizëm i shoqërisë së Strugës i ka bërë ata më pak të prekshëm ndaj narrativeve ekstremiste me bazë fetare, ndërkohë që nuk ishte kështu për ata jashtë qytetit¹¹. Shumë të anketuar vunë në dukje fshatin Labunishtë si një fshat veçanërisht problematik, me një të intervistuar që shkoi aq larg sa të thotë se “ka një frymë radikale në këtë fshat” dhe i anketuari nga Zyra e Kryetarit të Strugës duke e përshkruar se “pothuajse çdo [...] vajzë në fshat është e mbuluar nga një moshë e re”. Duke siguruar një pasqyrë se pse fshatrat rurale në komunën e Strugës mund të jenë më të prekshme ndaj ekstremizmit sesa qyteti, të intervistuarit nga grupi i fokusit gjithë-femëror i zhvilluar në Strugë vunë në dukje se ishte e vështirë për narrativet dhe përpjekjet P/CVE për të hyrë në këto fshatra, si simbolikisht ashtu edhe figurativisht:

Nëse pala maqedonase merr ndonjë iniciativë për këtë çështje, do të keqkuptohet automatikisht në kuptimin që ata po bëjnë diçka kundër popullsisë Myslimane ose popullsisë etnike shqiptare; nga ana tjetër, nëse shqiptarët etnikë marrin këto nisma, ato do të shihen përmes një konteksti politik.

Përderisa është gjithashtu e rëndësishme të theksohet këtu se individët që morën pjesë në punën në terren për këtë projekt nuk ishin nga zonat rurale të komunës së Strugës dhe si të tillë mund të “paragjykojnë” deri në një masë bashkëvendësit e tyre rural, është gjithsesi kritike të hetohet më tej ndarja urbane/rurale në aplikimin e programeve të P/CVE.

Së fundi, disa të anketuar në Strugë kanë identifikuar se ka pasur një boshllëk në bazë gjinore në adresimin e vulnerabiliteteve ndaj ekstremizmit brenda komunës së tyre. Përderisa grupi i fokusit 18-25 vjeçar e përshkroi atë: “Në Strugë shpesh mund të hasim [...] diskriminimin gjinor si një lloj ekstremizmi, ku femrat shihen në një ‘nivel më të ulët’ dhe nuk janë të barabarta me meshkujt” (Struga FG 18-25). Grupi i fokusit gjithë-femëror i zhvilluar në Strugë theksoi se aktivitetet edukative duhej të drejtoheshin për gratë e reja “sepse në këto mjedise, roli i gruas në familje dhe në shoqëri nuk diskutohet fare”. Kjo mungesë e fuqizimit të femrave, siç u përmend më parë, ishte një faktor gjinor i vulnerabilitetit të identifikuar nga të anketuarit. Pa një qasje gjinore për të kundërshtuar ekstremizmin, të anketuarit argumentuan, do të ishte e pamundur që gratë të ndjejnë të njëjtën barrë shoqërore, ashtu siç e gëzojnë partnerët meshkuj në komunën e Strugës (Struga FG i Grave).

3.3.2 Angazhimi në Komunitet dhe Ndërgjegjësimi Shoqëror

Të anketuarit theksuan nevojën për angazhim dhe debate publike rreth rreziqeve që vijnë nga ekstremizmi i dhunshëm dhe ekstremizmi në përgjithësi. Kishte një ndjenjë në mesin e të gjithë individëve që ngritja e ndërgjegjësimit ndaj këtyre temave ishte kritike, në mënyrë që secili në komunat e tyre të kuptonte në mënyrë të qartë rreziqet që vinin nga mundësimin që brenda shoqërive të tyre të zhvillohet ekstremizmi, për të nxitur kështu një linjë tjetër qëndrueshmërie kundër këtij fenomeni.

Që nga Çairi, Gostivari dhe Struga, të anketuarit theksuan se si angazhimi në debatet lidhur me ekstremizmin brenda komunave të tyre ka potencial për të ndihmuar në nxitjen e qëndrueshmërisë. Për shembull, në Çair, ka pasur një nismë të udhëhequr nga komuna për të futur debate dhe ligjërata në tri shkolla të mesme në Çair mbi temën e ekstremizmit (Zyra e Kryetarit të Çairit); megjithatë, nd-

¹¹ E artikulluar nga: fokus grupi i grave nga Struga, fokus grupi i Strugës 25-45, fokus grupi i Strugës 18-25, Zyra e Kryetarit të komunës së Strugës dhe intervista nga Struga.

ikimet afatgjate të kësaj nisme akoma kanë për t'u parë duke marrë parasysh se zbatimi i iniciativës është në fazat e para. Puna në terren sugjeron që kjo është përpjekja e parë e kësaj lloji iniciative në komunë. Në Strugë, një i anketuar nga komuniteti i medias u tregoi hulumtuesve për një projekt që kishin nisur për zhvillimin e debateve publike, dhe se asnjë iniciativë e tillë nuk kishte ekzistuar më parë dhe për ndikimin pozitiv që kishte ky projekt në mesin e anëtarëve të komunitetit. Megjithatë, megjithëse kishin zhvilluar një cikël përsëritës prej rreth njëzet debatesh në mbarë komunitetin, ky projekt duhej ndaluar për shkak të mungesës së fondeve shtetërore (Struga Media). Në këtë rast, megjithëse është e mundur të shohim ndikimin pozitiv të nismave të drejtuara nga komuniteti, pa mbështetjen e shtetit, këto iniciativa nuk do të jenë në gjendje të kenë jetëgjatësinë që kërkohet për ndikimin dhe suksesin e tyre të vazhdueshëm.

Sa i përket impakteve të iniciativave të tilla, të anketuarit në Gostivar potencuan se si angazhimi i komunitetit dhe ndërgjegjësimi shoqëror për rreziqet që dalin nga ekstremizmi kanë ndikuar pozitivisht në qëndrueshmërinë në komunat e tyre. Për shembull, një e intervistuar brenda grupit të fokusit 25-45 vjeçar transmetoi një përvojë ku një koleg “u përpoq ta radikalizonte atë” duke ia imponuar pikëpamjet e tij ekstreme asaj çdo ditë; megjithatë, “ai nuk pati sukses sepse [ajo] e kundërshtoi atë me faktet dhe idetë e saj të mësuara”, të mbledhura nga angazhimi shoqëror midis komunitetit të Gostivarit lidhur me rreziqet e paraqitura nga ekstremizmi.

3.3.3 Cilësia e Edukimit Fetar

Të anketuarit nga secila komunë theksuan nevojën për një cilësi më të rritur dhe efektive të edukimit fetar, përhapjen e parimeve të moderuara Islamike brenda shoqërisë më të gjerë dhe qasjen në një spektër të informacionit fetar nga besimet e ndryshme teologjike, në mënyrë që individët të mund të kuptojnë traditat e tyre fetare, si dhe ku ato i përshtaten traditave më të përgjithshme fetare. Më e rëndësishmja, të anketuarit me prejardhje të ndryshme - OJQ, imamë, mësues, etj. – të gjithë theksuan se qasja në edukimin e duhur fetar ishte një mjet kyç në luftën kundër ekstremizmit.

Është e mundur të shohim ndikimin e edukimit të përmirësuar fetar në kuadër të kontekstit të Gostivarit. Për shembull, grupi i fokusit prej 25-45 vjeçar identifikoi se, që nga publikimi i teksteve fetare Islamike të përkthyer në gjuhën shqipe nga arabishtja e tyre origjinale, më shumë të rinj kanë qasje në atë që konsiderohet si mainstream (shkolla Hanafi) dhe jo interpretime ekstreme të Islamit, dhe mund të vetë-edukohen për aspektet fetare të cilat ju interesojnë dhe janë relevante për ta (Gostivar FG 25-45). Ndonëse kjo ka qenë një arritje e rëndësishme, OJQ-ja me seli në Gostivar theksoi se kjo ishte po aq e rëndësishme të shihej edukimi fetar si një strategji afatgjate, në të cilën do të nxiten zëra të besueshëm të ardhshëm për interpretime të moderuara të Islamit (Gostivar OJQ). Një qasje e tillë do të nxiste një zhvillim ciklik të interpretimeve të moderuara të Islamit, të cilat janë të bazuara në besim, dhe të hapësirë më të vogël për zhvillimin e interpretimeve ekstremiste. Në këtë përpjekje, BFI-ja do të duhet të bëhet agjenti kryesor i ndryshimit, por pozicionimi i tyre në këtë rol duhet shumë të bazohet edhe për të adresuar deficitin në autoritetin e tyre dhe kontrollin mbi të gjitha segmentet e Bashkësisë Fetare Islame në Maqedoni.

Për më tepër, edukimi i duhur fetar duhet gjithashtu të përhapet edhe në nivelin e komunitetit, siç theksohet nga të anketuarit në Strugë. Individët në një nga grupet e fokusit u transmetuan hulumtuesve një tregim për një imam të sapoemëruar që arriti në një xhami në Strugë – kur filloi të predikonte në mënyrë radikale, popullata lokale reagoi instinktivisht dhe me vendosmëri dhe ai u largua menjëherë nga pozicioni i tij (Strugë, Grupi i Fokusit të Grave). Rëndësia e këtij akti nuk duhet të nënvleftësohet. Të intervistuarit në Strugë treguan se figurat fetare, si imamët apo muftitë ishin njerëzit më me ndikim në fshatrat më të vegjël në Maqedoni dhe si të tillë ishin figurat më të besueshme institucionale në ato komunitete (Struga Media). Po të ishte një imam ekstremist që të merrte një xhami në një komunitet më pak të qëndrueshëm se Struga, pasojat do të ishin më domethënëse.

Sa i përket projekteve të ardhshme në kuadër të kontekstit të Strugës, individët e konsultuar në një nga grupet e fokusit theksuan rëndësinë e krijimit të hapësirave të komunitetit të orientuara për të rinjtë, në të cilat edukimi fetar mund të zbatohet nga anëtarët e komunës për anëtarët e komunës. Siç u shprehën të anketuarit, një komunë mund të jetë po aq e fortë sa individët që banojnë

në të, dhe masa të tilla do të çonin në nxitjen e një mjedisi në të cilin mendimi dhe debati kritik mund të evoluojnë dhe të rriten brenda narrativeve jo-etnikisht-të-segreguara (Struga 25 -45 Fokus Grupi). Në këtë mënyrë, qëndrueshmëria individuale mund të përforcojnë qëndrueshmërinë e komunës si një tërësi, në të gjithë linjat etno-fetare apo politike.

Në suaza të Çairit, të anketuarit treguan se ende ka shumë për të bërë në drejtim të përmirësimit të arsimit fetar në përgjithësi, si dhe qasjes në të. Siç u përmend më parë, Çairi në veçanti ka pasur çështje serioze me xhamitë ekstremiste, në të cilat interpretimet ekstremiste të Islamit u perceptuan të kenë autoritet dhe autenticitet duke pasur parasysh rolin e xhamive në komunitet. Siç theksoi një mësues me banim në Çair, “arsimimi fetar, qoftë Islamik ose i Krishterë, është baza e mbrojtjes nga radikalizmi”; pa të, individët janë më të prekshëm ndaj mesazheve ekstremiste, pasi ata nuk posedojnë mjetet dhe faktet me të cilat do të kundërshtonin (Çair Mësues). Duke pasur parasysh autoritetin që gëzojnë aktualisht imamët në komunitete, imamët – së bashku me BFI – mund të jenë agjente integrale të ndryshimit në këtë fushë.

Megjithatë, ndërkohë që edukimi fetar konsiderohet si një mjet kritik në luftën kundër ekstremizmit, kishte një sentiment të përbashkët mes të gjithë të anketuarve që, nga një perspektivë e arsimit të përgjithshëm, marrëdhënia mësues-nxënës mund të luante një rol të rëndësishëm. Duke pasur parasysh se të anketuarit më parë theksuan se kjo marrëdhënie shpesh mund të ishte një faktor i vulnerabilitetit për individët e moshës shkollare – ose më saktë, keqpërdorimi i kësaj marrëdhënieje – një marrëdhënie e fortë dhe e fuqishme midis mësuesit-nxënësit mund të funksiononte për të zhdukur atë vulnerabilitet. Një marrëdhënie e tillë do të ndihmonte një mësues për të përcaktuar nëse një individ në demografinë e të rinjve po kalonte një proces të radikalizimit, do t'i siguronte nxënësit një figurë të besueshme të autoritetit, nëse ata do të ndiheshin të prekshëm ndaj mesazheve ekstremiste dhe do t'u siguronin mësuesve një platformë për të marrë masa të nevojshme kundër-mesazheve dhe të veprojnë si pikë kontakti brenda komunitetit shkollor.

Përderisa të anketuarit në Strugë artikuluan si më sipër, ata theksuan gjithashtu se është e rëndësishme që programet arsimore të jenë të strukturuar në mënyrë që mësuesit në një komunë të caktuar të ligjërojnë të njëjtën gjë, dhe njëkohësisht të identifikohen nëse mësuesit devijojnë në një mënyrë ekstremiste nga narrative e planifikuara. Për shembull, një mësues i shkollave të mesme theksoi rëndësinë e ndalimit të propagandës fetare në shkolla që ofrohen nga mësuesit dhe se mësuesit duhet të “hartojnë një strategji të përgjithshme lidhur me çështjen e mendimit ekstremist” (Strugë, Mësues). Megjithatë, shumica e kësaj përpjekjeje të strukturimit duhet të vijë nga niveli shtetëror. Siç është theksuar nga Fondacioni Evropian i Trajnimit, sistemi arsimor aktual në Maqedoni nuk është i përqendruar në arritjet dhe sukseset e nxënësve, e as në përpjekjet për standardizimin arsimor në të gjithë shtetin, por kontributet financiare futen në një sistem ku ekziston potencial për korrupsion (Mojsovska-Blaževski dhe Ristovska 2013, 7). Kështu, qasja e përgjithshme në arsim në nivelin shtetëror do të duhet të rishikohet në mënyrë që të plotësojë dëshirën për një edukim të strukturuar që punon në drejtim të nevojave të të gjithë nxënësve në të gjithë vendin, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike ose fetare.

3.3.4 Bashkëpunimi dhe Angazhimi Institucional

Bazuar në informacionin e mbledhur nga të anketuarit, ekziston një shkallë e ndryshme e bashkëpunimit institucional në luftën kundër ekstremizmit brenda çdo komuniteti. Gjithsesi, të intervistuarit treguan se shumë më tepër mund të bëhej në këtë kontekst dhe se angazhimi institucional në luftimin e këtij fenomeni ka qenë i pamjaftueshëm për nevojat e çdo komuniteti – megjithëse me nivele të ndryshme të pamjaftueshmërisë. Institucionet, në këtë kontekst, i referohen përgjithësisht qeverive lokale, komunale dhe shtetërore, institucioneve fetare si BFI, institucionet arsimore, institucionet që lidhen me kujdesin shëndetësor dhe institucionet shoqërore si OJQ-të, mes tjerave.

Të anketuarit në Gostivar u shprehën se ndërkohë që ka njëfarë bashkëpunimi në këtë sferë ndërmjet institucioneve qeveritare, të cilat kanë ndihmuar në qëndrueshmërinë e komunitetit, ekziston një bashkëpunim i pamjaftueshëm mes këtyre institucioneve dhe palëve të tjera të komunitetit. Për shembull, të anketuarit nga një OJQ me bazë fetare theksuan se ka hapësirë për bashkëpunim më të madh me institucionet fetare dhe përfaqësuesit të cilët, siç u përmendën më parë, shihen si figura të besuara brenda komunitetit dhe mund të veprojnë si një urë midis prerogativave qeveritare

dhe komunitetit më të gjerë (OJQ Gostivar). Individët e një prej grupeve të fokusit në Gostivar shprehën se ndërkohë që kishte një reduktim të perceptuar në përhapjen e ekstremizmit të dhunshëm pas aksioneve të policisë “Qeliza” të ndërmarrë së pari në vitin 2015¹², mungesa e bashkëpunimit me palët e tjera të komunitetit ka ndikuar pak në ndalimin përhapjes së ekstremizmit në përgjithësi brenda vendit (Gostivar FG 18-25).

Brenda kontekstit të Strugës, ky fenomen mund të shihet në veprim po ashtu. Siç u përmend, përderisa OJQ-të dhe institucionet e tjera sociale, si Këshilli Rinor, kanë qenë proaktiv në organizimin e aktiviteteve të ndryshme për të rritur ndërgjegjësimin për rreziqet e ekstremizmit dhe për të nxitur bashkëpunimin etno-fetar, mbyllja dhe/ose mungesa e qendrave rekreative brenda komunës së Strugës do të thotë se ata shpesh përpiqen të gjejnë hapësira fizike në të cilat do të zhvillojnë këto aktivitete (Struga Media.). Ndërkohë që një individ nga grupi i fokusit gjithë-femëror të Strugës identifikoi se ekziston një bashkëpunim ndërmjet OJQ-ve dhe qeverisë komunale, bashkëpunimi nuk është aq efektiv sa mund të ishte dhe mungon angazhimi adekuat (FG i Grave të Strugës). Për më tepër, bashkëpunimi më i formalizuar i OJQ-ve me qeverinë komunale të Strugës, për shembull, mund të ndihmojë në lehtësimin e organizimit të këtyre ngjarjeve dhe të forcojë më tej përpjekjet e qëndrueshmërisë brenda komunitetit.

Më tej, një individ i intervistuar nga Zyra e Kryetarit të Strugës gjithashtu identifikoi rëndësinë që individët luajnë në promovimin e bashkëpunimit të një institucioni me palët e tjera të interesit në komunitet. I intervistuari theksoi që figurat politike luajnë një rol kyç në vendosjen e një toni brenda komunitetit: “Unë mendoj se kryetari i tanishëm është mjaft liberal dhe po përpiqet të krijojë një mjedis që nxit multikulturalizmin dhe kjo është e njëjtë sime kryetarit e mëparshëm” (Zyra e Kryetarit Strugë). Kur shqyrtohet konteksti i Maqedonisë, në të cilin ndarjet etnike shpesh shfrytëzohen për përfitime politike, përzgjedhja e figurave të tilla është kritike në vendosjen e konteksteve në të cilat është e pranishme edhe dëshira për bashkëpunim me palët e interesuara dhe se ka një hapje ndaj diversitetit në nivelin qeveritar. Përderisa duhet të theksohet se ky opinion vjen nga një individ brenda zyrës së kryetarit, këto megjithatë paraqesin një pikpamje të rëndësishme që ka implikime të prekshme në nivelin lokal.

3.4 Përfundimi

Qëllimi i këtij kapitulli ishte të përfshihej me punën në terren në një mënyrë gjithëpërfshirëse dhe të paraqiste gjetjet duke përdorur kornizën e Hafez dhe Mullins. Përpjekja këtu ishte të demonstrohet se si të anketuarit i shihnin komunat e tyre, të gjendeshin ngjashmëritë midis këtyre pikëpamjeve, dhe të hetonin se si një komunë krahasohet me një tjetër në krahasim me tre faktorët e vendosur në fillim të këtij kapitulli. Për më tepër, ky kapitull paraqiti një pasqyrë tematike të faktorëve të perceptuar të qëndrueshmërisë të secilës komunë me qëllim që të ndihmonte në krijimin e një kup-timi gjithëpërfshirës të konteksteve të Çairit, Gostivarit dhe Strugës. Ky prezantim i gjetjeve do të përdoret tani si një set i të dhënave cilësore nga i cila do të nxirret një analizë në kapitullin vijues.

4 Analiza e Gjetjeve

Pas prezantimit të gjetjeve, ky kapitull ka për qëllim të përfshihet në një analizë më të gjerë të ndërveprimit ndërmjet asaj që të anketuarit identifikuan si faktorë që kontribuojnë në ndikimin e një komune, si dhe marrëdhëniet mes vetë komunave të Çairit, Gostivarit dhe Strugës. Për më tepër, ky kapitull do të diskutojë se si faktorët e lartpërmendur formojnë dinamikën e komunave në fjalë përballë kërcënimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe ekstremizmit më gjerësisht. Me rëndësi, ata do të përpriqen të adresojnë pse Çairi është komuna më e prekur nga ekstremizmi, përse Gostivari është prekur në masë të moderuar dhe pse Struga është më pak e prekur nga komunat e shqyrtuara në këtë raport. Për këtë qëllim, analiza do të përdor përsëri kornizën e Hafez dhe Mullins në hetimin e saj.

¹² Aksionet “Qeliza”, që filluan fillimisht në gusht të vitit 2015, ishin një seri veprimesh policore të ndërmarrë nga Ministria e Brendshme për të arrestuar një numër individësh të dyshuar për organizimin dhe rekrutimin e luftëtarëve të huaj në Maqedoni. Qytetet në qendër të këtyre bastisjeve ishin Shkupi, Gostivari, Tetova, Kumanova dhe Struga. Aksionet Qeliza mbeten veprimi më i rëndësishëm policor i ndërmarrë nga qeveria maqedonase si pjesë e një përpjekjeje më të gjerë kundër-terroriste.

4.1 Krijimi i mjedisit dhe strukturave mbështetëse

Krijimi i mjedisve dhe strukturave mbështetëse, brenda kornizës së Hafez dhe Mullins, i referohet hapësirave fizike dhe virtuale që krijojnë terren të përshtatshëm për ekstremizmin, duke përfshirë ekzaminime të nivelit të lartë institucional dhe shoqëror. Ky nën-seksion kërkon të analizojë se çfarë kanë të përbashkëta komunat në nxitjen e mjedisve të tilla dhe në mënyrë të barabartë përpiqet të përcaktojë se cilat faktorë individualë kanë gjasa të kontribuojnë në ndryshueshmërinë e ndikimit mes tyre nga ekstremizmi.

Në punën e tij për ekstremizmin në Ballkanin Perëndimor, Azinoviç (2018, 7) ka identifikuar se zonat në të cilat Myslimanet janë një minoritet (relativ) janë më të favorshme për ekstremizmin e dhunshëm. Edhe pse të gjitha komunat e studiuara në këtë raport janë me shumicë Myslimane, gjetjet e Azinoviçit shqyrtohen më thellë në kontekstin e Çairit, komuna më e prekur nga komunat e studiuara në këtë raport. Megjithatë vetë Çairi është një komunë me shumicë-Myslimane, është vetëm një nga dhjetë komunat që përbëjnë kryeqytetin me shumicë Ortodokse të Shkupit, ndërsa dy të tjerat janë komuna me shumicë Myslimane. Si i tillë, në perceptimin psikologjik, një Mysliman brenda Çairit është një pakicë brenda vetë qytetit të tij. Është e pranueshme që tensionet ndëretnike të ndjehen më me vëmendje në hapësirën e Shkupit, duke pasur parasysh këto gjetje dhe vendin e Shkupit si kryeqytet i Republikës, duke rezultuar kështu në një mjedis më të përshtatshëm ndaj prirjeve ekstremiste. Kur analizohen nga perspektiva e tensionet e vazhdueshme ndëretnike të pa-adresuara në periudhën pas Konfliktit të Armatosur, padyshim që këto kanë çuar në ngritjen e mentalitetit “ne kundrejt tyre” në disa komunitete, që është një narrativë lehtësisht e shfrytëzueshme për ideologët ekstremistë dhe rekrutuesit brenda një mjedisi të tillë.

Sidoqoftë, në Gostivar dhe në Strugë, ka pasur përpjekje të dukshme për të nxitur multikulturalizmin, diversitetin dhe vlerat e një shoqërie ndëretnike. Të anketuarit sugjeruan se anëtarët e këtyre komunave janë të informuar mirë për vlerat e diversitetit. Për më tepër, Struga theksoi se është vendosur një përpjekje e përbashkët për krijimin dhe promovimin e aktiviteteve dhe programeve që nxisin integrimin dhe bashkëpunimin ndëretnik, duke forcuar më tej qëndrueshmërinë e komunës ndaj faktorëve që kontribuojnë në një mjedis ku ka ekstremizëm. Në Çair, si krahasim, nuk kishte prova për të sugjeruar që janë zbatuar narrativet që promovonin diversitetin dhe bashkëjetesën etno-fetare.

Në të gjithë tre komunat, hulumtimi tregoi se apatia institucionale ndihmoi në nxitjen e mjedisve të përshtatshme për ekstremizmin, veçanërisht në nivel shtetëror. I funksionalisht, ekziston një perceptim se institucionet shtetërore nuk kishin as vullnet dhe as njohuri për të trajtuar në mënyrë adekuate kërcënimin ekstremist, dhe se shteti ka zgjedhur më gjerësisht të përqendrohet në ekstremizmin e dhunshëm vetëm nëpërmjet politikave përkriminalizimin e tyre, sesa në zbatimin e iniciativave në nivel lokal për të adresuar përhapjen e ekstremizmit brenda komunave. Një mangësi e tillë në strukturat që mbështesin angazhimin e komunave në luftën kundër ekstremizmit, padyshim që ka ndikuar në krijimin e mjedisve të përshtatshme.

Megjithatë, ideja e krijimit të mjedisve të shkaktuara si rezultat i çështjeve institucionale u manifestua në mënyra të ndryshme në të tri komunat. Përderisa qeveritë komunale në Strugë dhe Gostivar kishin ngritur organe vendore për të trajtuar çështjet që lidhen me kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm, në të dyja rastet, këto organe konsideroheshin joefektive për shkak të niveleve të ulëta të besimit institucional. Megjithatë, në Çair, sipas rezultateve të raportit, asnjë organ i tillë nuk ekziston ose ka ekzistuar ndonjëherë, gjë që – duke pasur parasysh mungesën e përgjithshme të dëshirës në mesin e komunitetit edhe për të diskutuar çështjet që lidhen me ekstremizmin – është në përputhje me gjetjet në Çair në përgjithësi.

Për më tepër, gjetjet sugjerojnë se ndërkohë që është ndërmarrë një bashkëpunim institucional brenda Gostivarit dhe Strugës, shumë më tepër mund të bëhet akoma për të forcuar efektivitetin e përpjekjeve të tilla në zvogëlimin e mjedisve të përshtatshme për ekstremizëm. Bashkëpunimi dhe angazhimi i mëtejshëm i të gjitha palëve të interesit do të krijonte një mjedis që do të nxiste një qasje më gjithëpërfshirëse (holistike) për të luftuar ekstremizmin e dhunshëm dhe mund të punonte për të trajtuar më gjerësisht përhapjen e ekstremizmit brenda secilës komunë. Për më tepër, një qasje holistike do të mundte paralelisht të ndërtojë qëndrueshmërinë e komunës përmes angazhimit individual dhe të punonte për të inkurajuar përkatësinë pan-etnike të bazuar në angazhimin qytetar.

Në një nivel institucional fetar, kishte kritika të konsiderueshme në të gjitha komunat dhe kjo lidhej me një papërshtatshmëri të perceptuar në edukimin fetar në veçanti. Në të gjitha rrethanat, të anketuarit ishin shumë kritikë ndaj BFI-së, të cilët u përshkruan si një institucion me mungesë të besimit publik, kishin pak-ose-fare autoritet mbi xhamitë e dyshimta dhe ishte mendimi se kanë një injorancë sa i përket çështjes problematike në lidhje me para-xhematet. Të marra së bashku, mosveprimi i BFI-së – qoftë ajo nga zgjedhja apo nga rrethanat e vështira – ka lejuar zhvillimin e mjediseve të favorshme për përhapjen e ekstremizmit. Më problematike, mungesa e kontrollit të BFI-së ka pasur pasoja të rëndësishme në Çair, ku para- xhematet ekstremiste – në numrin më të lartë në Çair, së bashku me komunën e Sarajit – ndihmuan për të radikalizuar ndjekësit e tyre në nivele të konsiderueshme. Përderisa të anketuarit në Strugë dhe Gostivar shprehën pakënaqësinë e tyre me udhëheqjen e BFI-së, asnjëra nga ato komuna nuk i identifikuan para-xhematet si një problem specifik dhe të identifikueshëm brenda komunave të tyre.

Lidhur thellë me kritikën mbi BFI-në, të anketuarit identifikuan mungesën e një edukimit fetar; megjithatë, relativisht, përvojat e Strugës dhe Gostivarit ndryshonin shumë me atë të Çairit. Gjetjet në Gostivar vunë në dukje se çështja lidhej me zbatimin joefektiv të mësimëve për religjionet në shkolla, ndërsa gjetjet e Strugës treguan se arsimit fetar në shkolla edhe pse ekziston, kishte nevojë për diversifikim. Në kontekstin e Strugës, për më tepër, çështja e arsimit u prezantua edhe përmes një thjerrëze gjinore, në të cilën dobësitë arsimore ishin më pak përgjatë vijave etnike, por më tepër përgjatë vijave gjinore, veçanërisht në zonat rurale. Duke pasur parasysh prirjen e radikalizimit që të ndodhë përgjatë vijave etnike, ky lloji i mjedisit lehtësues për ekstremizmin është bërë më pak problematik në kontekstin e Strugës.

Për më tepër, si Gostivari dhe Struga kanë prezantuar struktura përkrahëse të ndryshme, por të ngjashme, të cilat duket se kanë ndikuar pozitivisht në zvogëlimin e mjediseve mundësuese nga pikëpamja e edukimit. Në Gostivar, për shembull, tekstet fetare janë përkthyer në shqip, duke u dhënë individëve qasje të drejtpërdrejtë në ungjijtë në gjuhën e tyre amtare. Megjithatë, ndonëse e rëndësishme, kjo iniciativë nuk duket të jetë pjesë e një strategjie afatgjatë për përmirësimin e edukimit fetar. Në Strugë, qëndrueshmëria fetare mund të interpretohet si e nxitur në nivel lokal, në të cilën komuna është përpjekur të mbështesë dhe ngrisë figurat e moderuara fetare, siç janë imamët. Struktura të tilla, veçanërisht të institucionalizuara lokalisht, ka të ngjarë të kenë ndikuar pozitivisht në zvogëlimin e mjediseve të përshtatshme brenda kontekstit komunal të Strugës. Përsëri, megjithatë, kjo nuk duket të jetë pjesë e një strategjie afatgjatë dhe nuk përfshin aktorët kryesorë.

Siç u përmend edhe më parë, në kontekstin e Çairit, natyra e polarizuar e shoqërisë dhe përhapja e xhamive ekstremiste e bën të vështirë që iniciativat edukative të mbajnë dhe të mbështesin qëndrueshmërinë e komunës ndaj mjediseve që ndihmojnë për të mundësuar ekstremizmin. Gjetjet gjithashtu treguan se mungonte dëshira në mesin e popullatës për të kërkuar të vërtetat fetare dhe natyra e ndarë e shoqërisë në Çair vetëm ndikon për të përçarë narrativet etno-fetare. Në këtë mënyrë, mungesa e integritetit, si dhe tolerancat fetare dhe etnike, ka punuar për të krijuar një shoqëri të mbyllur në të cilën individët ekzistojnë në kufijtë ideologjikë me pak dëshirë për të parë përtej pikëpamjeve të tyre. Si e tillë, një shoqëri e vetë-margjinalizuar krijon kështu hapësirë për t'u zhvilluar narrative të mëtejshme ekstremiste.

Përfundimisht, ndërkohë që të anketuarit në të tri komunat ndajnë të përbashkëta në aspektin e faktorëve që kontribuojnë në krijimin e mjediseve të përshtatshme për ekstremizëm, faktorët ndihen në nivele të ndryshme dhe në kontekste të ndryshme komunale. Pozita e Çairit si një komunitet pakicë brenda një qyteti më të madh ka pasur padyshim një rol dhe e veçon atë nga realitetet në terren të ndjera në Gostivar dhe Strugë. Siç shohim më thellë, ndikimi i Çairit nga fenomeni para-xhemateve ka treguar se në nivel lokal ka hapësirë që të zhvillohen narrativet ekstremiste, me pak ose aspak struktura mbështetëse institucionale për të ndihmuar në parandalimin e një mjedisi të tillë.

4.2 Ideologjitë ekstreme, rrjetet dhe lidhjet interpersonale

Siç është përshtatur nga korniza e Hafez dhe Mullins, ndikimi i ideologjive ekstreme flet për mënyrën se sa me ndikim janë narrativet e tilla brenda një komune të caktuar, dhe në një nivel individual, pse tregimet e tilla rezonojnë aq thellë. Ideologjitë e tilla përhapen nëpërmjet rrjeteve, dhe rrjetet mbështeten nëpërmjet lidhjeve ndërpersonale midis rekrutuesve dhe atyre që janë të hapur ndaj thirrjes ekstremiste. Si i tillë, ky nën-seksion kërkon të identifikojë faktorët që kontribuojnë në një komunë që më pak ose shumë të preket nga ndërlidhja mes ideologjive, rrjeteve dhe lidhjeve ndërpersonale brenda kontekstit të Maqedonisë.

Hulumtimi tregoi se proksimiteti (afërsia) me ekstremizmin ishte një faktor i rëndësishëm në ndikimin e një komune. Siç u tha më parë, “proksimiteti” i referohet qasjes fizike dhe virtuale deri tek materialet, idetë dhe propaguesit ekstremistë. Megjithëse do të diskutohet në detaje më të hollësishme në nën-seksionin pasues, proksimiteti gjithashtu mund t’i referohet asaj se sa “afërt” për një individ mund të ndihet një ideologjie ekstreme; që nënkupton, sa e lidhur dhe domethënëse është ajo ideologjia për narrativet e tyre personale. Si i tillë, rrjetet nuk duhet të jenë vetëm fizike, por gjithashtu mund të jenë po aq virtuale; për më tepër, lidhjet ndërpersonale mund të krijohen përmes të dyja formave të ndërveprimit.

Të anketuarit nga të gjitha komunat identifikuan se kishte lidhje midis afërsisë ideologjike dhe proceseve të radikalizimit, edhe pse përvojat e tyre të këtij fenomeni ndryshonin shumë. Gjetjet nga Gostivari dhe Struga, për shembull, treguan se mediat sociale ofruan proksimitet ideologjik si global ashtu edhe lokal; për Gostivarin, media sociale shihej si një mjet për rekrutuesit për të identifikuar rekrutët e mundshëm, qoftë në nivel ndërkombëtar ashtu edhe në nivel lokal, ndërsa për Strugën ajo u përdor si medium nga ekstremistët për të shuar pikëpamjet e moderuara që ishin relevante në nivel lokal ose ndërkombëtar.

Për Çairin, megjithatë, proksimiteti ideologjik pothuajse tërësisht u shpreh nëpërmjet ndërveprimit të botës reale. Siç u theksua në kapitullin e mëparshëm, Çairi ishte shtëpi e një numri të xhamive ekstremiste – para-xhemateve – dhe ishte burimi për një koncentrim të lartë të luftëtarëve të huaj që udhëtonin në territorin e Sirisë dhe Irakut nën kontrollin e ISIL. Këto gjetje do të sugjerorin se të qenit në praninë fizike të rekrutuesve dhe ideologjive ekstremiste – në vend se vetëm prania e tyre në internet – e bën një individ më të prekshëm nga radikalizmi dhe lejon bashkimin e individëve ekstremistë me prirje të ngjashme në një fenomen vetë-përvetësues të radikalizimit.

Ky sugjerim, gjithashtu, është në përputhje me gjetjet e Iniciativës Atlantike (Atlantic Initiative 2017, 15), të cilët kanë demonstruar se brenda kontekstit të Ballkanit Perëndimor, ndërveprimi i drejtpërdrejtë është një radikalizues shumë më i fortë se interaksioni online, ku takimet e drejtpërdrejta janë ndjekur nga një ndërveprim mes-miqësh (ang. peer-to-peer), shpesh me individë me prirje të njëjtë, ku një pikëpamje botërore shumë specifike përforcohet përmes dinamikës së grupit”. Në këtë mënyrë, krahasuar me Strugën dhe Gostivarin, afërsia si vulnerabiliteti brenda kontekstit të Çairit mund të shihet si gjeografik, me ndërveprimin fizik ndërmjet rekrutuesit dhe individit të pambrojtur duke krijuar një mjedis në të cilin një lloj socializmi ekstremist mund të lulëzojë.

Ndryshe nga Çairi, Gostivari dhe Struga janë përpjekur të luftojnë kundër ideologjive ekstreme përmes socializimit të anëtarëve të komunitetit në debate dhe bisedë. Gjetjet treguan se, në veçanti, nxitja e vetëdijes publike lidhur me rreziqet e paraqitura nga ekstremizmi ndihmoi individët në komunat e lartpërmendura të përfshiheshin në narrative të përbashkëta anti-ekstremiste. Në Strugë, më së shumti, kjo u ndihmua nga një seri leksionesh dhe debatesh mediatike me aktorët kryesorë; megjithatë, megjithëse ky efektivitet bazohet nga vrojtimi i përgjithshëm, kjo nuk ishte një iniciativë-shtetërore dhe mungonte financimi afatgjatë, i cili flet për disa nga çështjet që lidhen me bashkëpunimin institucional të theksuar në kapitullin e mëparshëm.

Ndërsa është e rëndësishme të theksohen kundërmasat që Gostivari dhe Struga kanë marrë në përpjekje për të kompensuar ideologjitë ekstreme, dallimi kryesor midis tri komunave përfundimisht qëndron në çështjen e proksimitetit. Si puna në terren ashtu edhe hulumtimi dytësor tregojnë që ndërveprimi drejtpërdrejtë – ndryshe i përshkruar si ideologji lokale dhe jo globale – është radikalizmi më efektiv në krahasim me ndërveprimin në internet, duke nënkuptuar kështu marrëdhënien e rëndësishme midis rrjeteve lokale, fizike dhe ideologjive ekstreme brenda kontekstit të Maqedonisë. Si i tillë, ky zbulim do të ndihmonte në shpjegimin e ndikimit të lartë të komunës së Çairit.

4.3 Pakënaqësitë kolektive dhe personale

Brenda kornizës së Hafez dhe Mullins (2015, 963), pakënaqësitë kolektive dhe personale përdoren nga ekstremistët për të përhapur një “identitet shoqëror komunalist” që është “në kundërshtim me kulturën hegjemoniste”. Pranimi i këtyre narrativeve çon në një “dinamikë të vetë-përforcuar të përjashtimit”, e cila ndihmon për të përhapur më tej “tjetërsimin” e një grupi (2015, 963). Prandaj, ky nën-seksion kërkon shkurtimisht të analizojë manifestimet e narrativeve të pakënaqësive kolektive dhe personale brenda komunave të studiuara dhe çfarë roli luajnë këto narrative në përcaktimin e lartësisë së ndikimit në një komunë nga ekstremizmi.

Siç është artikuluar në nën-seksionet e mëparshme, gjetjet tregojnë se të tre komunat u ekspozuan nga faktorë tërheqës ndaj ideologjive ekstremiste përmes kornizave lokale dhe globale. Këta faktorë tërheqës, për më tepër, shpesh artikulohehin përmes narrativeve të pakënaqësive që ishin përshtatur edhe përmes një objektivi global dhe/ose lokal – domethënë, rekrutuesit shfrytëzojnë narrativet e panjohura lokale dhe pan-Myslimane për të targetuar ata që janë më të ndjeshëm ndaj mesazheve ekstremiste. Faktorët e përbashkët të shprehur në të tri komunat ishin një ndjenjë – e perceptuar apo thënë ndryshe – e alienimit, izolimit ose margjinalizimit.

Në kontekstin e Gostivarit, korniza e izolimit, e artikuluar nëpërmjet narrativeve të rrëmbyera të pakënaqësive, u vu re të luante një rol në radikalizimin në mënyrë sistematike, por shihej të prekte kryesisht demografi të caktuara të moshës; në mënyrë specifike, ato në adolehencë ose në të njëzetat e hershme. Ndryshe nga kjo, gjetjet nga Struga i shihnin narrativet e pakënaqësive nga izolimi të dobishme vetëm në mënyrë periodike dhe jo sistematike për individët në atë komunë. Periudhat zgjedhore – shpesh të përcaktuara nga nxitja e ndarjeve të përkohshme brenda shoqërisë për përfitime politike - u konsideruan si momente kritike kur një ndjenjë e alienimit mund t'i bënte anëtarët e komunës më të prekshëm ndaj mesazheve ekstremiste. Në këtë mënyrë, rrëfimet e pakënaqësive që ndërtoheshin mbi ndjenjat etno-nacionaliste dhe shfrytëzimi i politikës së identitetit në mënyra ekstreme të shprehura gjatë periudhave zgjedhore u kishin më shumë kuptim. Megjithatë, gjetjet treguan se, ndryshe nga konteksti i Gostivarit në të cilin ky perceptim i alienimit apo izolimit ishte i vazhdueshëm, a rasti i Strugës ishte i ndryshëm, duke e bërë kështu komunitetin më pak të prekshëm nga kjo perspektivë.

Çairi, edhe në këtë, ishte më i përjashtuar nga të tri komunat në këto gjetje. Çairi, siç përcaktohet nga të anketuarit e saj, është një komunë me shumë ekstreme; një shoqëri e cila është e polarizuar në vija të shumta të ndërlikuara dhe shpesh të ndërthurura, që nxit një izolim të thellë dhe të gjatë të nën-grupeve brenda komunitetit më të madh të Shkupit. Në këtë kontekst, ekstremizmi politik është thellësisht i lidhur me ekstremizmin ideologjik dhe/ose fetar, dhe individët janë socializuar në grupe ekstreme në të dyja anët.

Duke qenë se Çairi është një zonë kryesisht shqiptare etnike brenda Shkupit, kjo ndjenjë e perceptimit dhe/ose vetë-alienimit dhe izolimit është bërë gjithnjë e më e zymtë për individët brenda dhe jashtë atij komuniteti. Si e tillë, komuna vazhdon të jetë në një gjendje të vazhdueshme margjinalizimi, duke i bërë anëtarët e saj – dhe komunitetin në tërësi – më të pambrojtur nga narrativet e pakënaqësive që ndjehen si kolektive. Me Çairin, është e mundur të shihet se çfarë Hafez dhe Mullins nënkuptojnë me “dinamizmin e vetë-përforcuar të përjashtimit”: ndarja e thellë brenda komunës në të dyja anët ndikon për të përforcuar më tej një perceptim të përjashtimit dhe siguron që narrativet e pakënaqësive të normalizohen. Në këtë mënyrë, narrativet etno-nacionaliste janë të ndërthurura së bashku me ideologjitë ekstremiste për të konstruktuar narrative kolektive që kanë kuptim, të cilat ndikojnë në mënyrë ciklike për të rekrutuar dhe radikalizuar.

Pa dyshim, bindshmëria e narrativeve nga pakënaqësitë kolektive dhe personale humbet nëse një shoqëri është relativisht e bashkuar. Me Strugën, e definuar si më së pak e prekur brenda strukturës së këtij raporti, është e mundur të shihet se si “periudha periodike” të rezonancës reflektohen brenda niveleve të saj të ekstremizmit. Mbi këtë, rezonanca sistematike e Gostivarit kontribuon në ndikimin e tij mesatar, dhe duke pasur parasysh ekstremitetin e qenësishëm të Çairit si një komunë, ndikimi i rezonancës së narrative të pakënaqësive është i vetë-kuptueshëm.

5 Konkluzioni dhe Rekomandimet

Në përgjithësi, ky raport kërkoj të hetojë se çfarë e bën një komunë më pak ose më shumë të prekur nga fenomeni i ekstremizmit të dhunshëm sesa një tjetër. Për këtë qëllim, raporti shqyrtoi tri komuna në Republikën e Maqedonisë – Çairin, Gostivarin dhe Strugën – përmes kryerjes së intervistave gjysmë të strukturuar dhe fokus grupeve në përpjekje për t'u angazhuar në mënyrë efektive në këtë diskutim. Pas një prezantimi të hollësishëm të gjetjeve të punës në terren, raporti pastaj paraqiti një analizë të hulumtimit për të ndihmuar në identifikimin e disa prej shkaqeve dhe korrelacioneve të ekstremizmit të dhunshëm në kontekstin e Maqedonisë.

Në analizën e tij, raporti përdori një version të modifikuar të kornizës së njohur të Mohammed Hafez dhe Creighton Mullins. Përmes punës së tyre në sintetizimin e qasjeve empirike për të analizuar ekstremizmin, ata kanë argumentuar se radikalizimi nuk është një lëvizje e cila ndjek një doracak hap-pas-hapi; përkundrazi, ajo përshkruhet si një gjëgjëze (puzzle) e përbërë nga copa të shumta, të ndërthurura, të cilat ndërtojnë një fotografi ekstremiste. Siç Hafez dhe Mullins (2015, 970) përshkruajnë:

Ngjashëm të strukturuar si një puzzle që mund të zbulojë imazhe të ndryshme pasi pjesët e tyre të jenë ndërlidhur, rastet e radikalizimit mund të shfaqin shumëllojshmëri të jashtëzakonshme edhe kur variabilet e radikalizimit përsëriten. [...] Metafora e puzzle-it është gjithashtu e dobishme për të nxjerrë në pah natyrën e ndërvarur të variablave të radikalizimit, ku një pjesë e puzzle-it përmban elemente të pjesëve tjera të ngjitura.

Brenda kontekstit të Maqedonisë, një qasje e tillë është kritike. Përderisa është e pamundur të nxjerrim të vërteta absolute nga një studim i tillë, duke pasur parasysh diversitetin e realiteteve lokale dhe në terren, kapitulli i Analizës së Gjetjeve të këtij raporti zhytet thellë në hulumtimin për të nxjerrë të vërteta specifike të komunave që janë të pjekura për hetime të mëtejshme. Këto gjetje flasin për realitetin se radikalizmi drejt ekstremizmit nuk është një proces linear, por më tepër është një sërë rrethanash që bashkohen për të kultivuar një mjedis të përgjithshëm që është i përshtatshëm për përhapjen e ekstremizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm.

Në përgjithësi, rezultatet e të gjithë aktorëve të intervistuar për qëllimet e këtij raporti ishin të ngjashme. Faktorët e vulnerabilitetit dhe qëndrueshmërisë ndaj ekstremizmit të dhunshëm shpeshherë ishin imazhe të pasqyruara të njëra-tjetrës – për shembull, mungesa e një edukimi fetar cilësor si një vulnerabilitet në një komunë përkundrajt cilësisë/qasjes në edukimin fetar si një faktor i qëndrueshmërisë në një tjetër. Ky “imazh i pasqyruar” ka qenë një gjetje integrale dhe siguron një hapësirë nga e cila mund të nxirren rekomandime të politikave.

Në një përpjekje për të adresuar dhe folur për disa nga këto gjetje, raporti propozon tre rekomandime të politikave:

1) *Strategjia P/CVE e Maqedonisë duhet të zhvendoset nga të qenit një qasje qeveritare nga lart-poshtë në atë që është më “holistike” dhe që angazhon, fuqizon dhe edukon aktorët vendorë institucionalë në këto përpjekje.*

Një ndryshim i tillë në politika është i rëndësishëm për arsye të panumërta. Mbi të gjitha, do të pranohej se qasja ndaj “sekuritizacionit” që deri më sot është zbatuar në Maqedoni është e pamjaftueshme. Ndërkohë që qeveria e Maqedonisë ka bërë përpjekje të fundit për të përmirësuar strategjinë e saj të P/CVE së bashku me strategjinë e saj kundër terrorizmit, këto përpjekje kanë mbetur në masë të madhe sipërfaqësore dhe nuk pasqyrojnë realitetin bazë që çon në radikalizim. Historikisht, për më tepër, këto përpjekje kanë qenë reaktive dhe jo proaktive, duke pasur kështu pak ndikim mbi ekstremizmin si një fenomen dhe thjesht vetëm mbi manifestimet e tij të dhunshme. Më e rëndësishmja, megjithatë, një ndryshim i tillë në qasjen e politikave do të demonstronte një pranim të rëndësishëm që ekstremizmi dhe ekstremizmi i dhunshëm brenda kontekstit të Maqedonisë janë edhe një çështje sociale, sa ç'janë edhe një çështje sigurie, dhe veprimi që reflekton se ndryshimi në këtë mentalitet duhet të përqafohet.

Ky ndryshim do të siguronte që krijuesit e ndryshimeve në një komunë të jenë anëtarë të vetë komunitetit dhe se ndryshimi që nxitet është i përshtatshëm për nevojat dhe narrativet lokale të njerëzve në atë komunitet. Një politikë e tillë do të bëjë që aktorët lokalë institucionalë, si educa-

torët, OJQ-të, punonjësit socialë, udhëheqësit fetarë së bashku me përfaqësuesit e shtetit, siç janë zyrtarët e komunës, të angazhohen në zbatimin e reagimeve parandaluese dhe afatgjata ndaj ekstremizmit. Është e rëndësishme që këta individë të angazhohen, të fuqizohen dhe të edukohen në lidhje me nevojat e komunitetit të tyre në një kundër-narrativ gjithnjë-në-evolucion ndaj ekstremizmit, duke lejuar kështu që këto përpjekje të jenë vetë-qëndrueshme, lokale dhe të participative.

2) *Diskursi për parandalimin dhe kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm duhet të evoluojë për të përfshirë edhe format e ekstremizmit etno-nacionalist dhe djathtist që janë në rritje në Maqedoni.*

Megjithëse ky raport u përqendrua kryesisht në rreziqet e paraqitura në kontekstin e Maqedonisë nga ekstremizmi Islamist, duhet të ketë një kuptim nga politikbërësit se fenomeni i ekstremizmit nuk qëndron vetëm brenda një narrativi. Deri më sot, shumica e vëmendjes dhe hulumtimeve të ndërmarra nga iniciativat ndërqeveritare dhe organizatat joqeveritare janë përqendruar në P/CVE të synuara vetëm ndaj ekstremizmit Islamist. Nga një këndvështrim më i gjerë, një fokus i tillë ka potencialin për të marginalizuar më tej dhe për të përjashtuar Myslimanët në shoqërinë e Maqedonisë nëse strategjitë efektive dhe gjithëpërfshirëse të P/CVE nuk zbatohen. Kjo potencialisht mund të lërë hapësirë për atë komunitet që të ndjehet në mënyrë specifike në shënjestër të iniciativave strukturore të cilat kanë potencialin të supozojnë fajin e tyre për shkak të identitetit të tyre etno-fetar.

Për më tepër, fokusi vetëm në ekstremizmin Islamist e injoron ekstremizmin etno-nacionalist dhe të djathtë që është në rritje në Maqedoni. Derisa nuk është fushë-veprimi i këtij raporti, është e rëndësishme të theksohet se epoka e post-Konfliktit të Armatosur ka lënë hapësirë po aq për lindjen e narrativeve ekstremiste nacionaliste pro-maqedonase. Ndërkohë që këto rrëfime nganjëherë konsiderohen më legjitime në kuadër të diskurseve kryesore politike në Maqedoni midis disa partive, ndryshimi në qeverisje i ka zhvendosur këto narrative në nivelin bazë, ku ata kanë potencial për të radikalizuar më tej në mënyrë më-pak-të-errët, kështu duke i bërë ata gjithnjë e më të vështirë për t'ju u kundërvënë.

3) *Duhet të ndërmerren hulumtime të mëtejshme për të shqyrtuar marrëdhëniet midis etnisë, perceptimit të pushtetit dhe ndarjes shoqërore në një përpjekje për të përcaktuar se si këto variabla risin vunerabilitetin brenda një komune. Gjetjet e këtij hulumtimi duhet të jenë informative për programet e ardhshme për P/CVE.*

Nga një pikëpamje e nivelit të lartë, një nga gabimet më të mëdha të qasjes aktuale të qeverisë ndaj P/CVE është se shumica e strategjisë është e rrënjosur në supozime dhe jo në kërkime. Aty ku hulumtimi ka informuar strategjinë e qeverisë, ajo ka qenë sipërfaqësore dhe reflekton gjetjet e gjera në lidhje me ekstremizmin, në vend që të jetë i veçantë për territorin e Republikën së Maqedonisë. Rreziku në një qasje të tillë është i qartë – pa gjetjet specifike për Maqedoninë për të informuar strategjinë e P/CVE, nuk ka gjasa që strategjia e përmendur do të jetë e suksesshme. Ndërsa strategjia e qeverisë ka bërë mirë që të përafrohet me normat e BE-së dhe të OKB-së, ajo nuk e ka bërë këtë në një mënyrë që bazohet në kërkime gjithëpërfshirëse.

Edhe pse projektet kërkimore si ky raport janë ndërmarrje të rëndësishme që mund të ndihmojnë në formulimin e politikave më efektive, është e rëndësishme që qeveria të angazhohet me palët e interesit në të gjitha nivelet e shoqërisë në çdo përpjekje kërkimore. Nga pikëpamja e fokusit të hulumtimit, ky raport rekomandon – bazuar në gjetjet e veta – të ndërmerren kërkime të mëtejshme që hulumtojnë marrëdhënien ndërmjet etnisë, perceptimit të pushtetit dhe ndarjes shoqërore; kjo do të kishte potencial të fliste për çështje që lidhen me ekstremizmin Islamist, por po ashtu edhe me ekstremizmin etno-nacionalist/të djathtë. Në situatë ideale, kjo do të çonte në krijimin e një strategjie mirë-të konceptuar për P/CVE, e cila ka shtirje të gjerë, gjithëpërfshirëse në zbatimin e saj dhe – së bashku me një mendësi “holistike” dhe jo “lartë-poshtë” – do të siguronte që strategjitë e P/CVE nuk janë thjesht reaktive, por edhe proaktive.

Referenca

- Aly, A. (2015).** “Editorial: Finding meaning for countering violent extremism”. *Journal of Policing, Intelligence and Counter Terrorism* 10: 1-2
- Azinovic, V. ed. (2017).** *The Atlantic Initiative. Between Salvation and Terror: Radicalisation and the Foreign Fighter Phenomenon in the Western Balkans.* Available at: http://www.atlantskainicijativa.org/bos/images/BETWEEN_SALVATION_AND_TERROR/BetweenSalvationAndTerror.pdf (Accessed 05 June 2018)
- Azinovic, V. (2018).** *Regional Report: Understanding Violent Extremism in the Western Balkans.* Western Balkans Extremism Research Forum, British Council. Available at: https://www.british-council.ba/sites/default/files/erf_report_western_balkans_2018.pdf (Accessed 1 August 2018)
- Bechev, D. (2017)** “What is Happening in Macedonia?” *al-Jazeera.* 30 April. Available at <https://bit.ly/2Kowolb>. (Accessed 17 June 2018)
- Bender, K. (2013).** “How the US and EU Stopped a War and Nobody Noticed: The Containment of the Macedonian Conflict and EU Soft Power”, in: Berdal, M., Zaum, D. (2013). *Political Economy of Statebuilding: Power Peace.* London: Routledge.
- CEIC (2018).** “Macedonia Unemployment Rate – State Statistical Office of Macedonia”. Available at: <https://www.ceicdata.com/en/indicator/macedonia/unemployment-rate> (Accessed: 1 August 2018)
- Cekik, A. and Petkovska-Hristova, L. (2014).** “Discrimination in Macedonia’s Multi-Ethnic Society: Perceptions of Inequality Among the Student Population.” *New Balkan Politics.* No. 15. Available at <http://www.newbalkanpolitics.org.mk/item/discrimination-in-macedonia-s-multi-ethnic-societyperceptions-of-inequality-among-the-student-population#.W5GVQegzaMq>. Accessed 6 September 2018.
- Day, M. and Sherlock, R. (2017).** “More than 70 injured as protestors storm Macedonia’s parliament and attack politicians and police”. *The Telegraph,* 28 April. Available at: www.telegraph.co.uk (Accessed 1 August 2018)
- European Commission (2015).** “Agreement in Skopje to overcome the political crisis”. *European Union,* 15 July. Available at: https://ec.europa.eu/commission/commissioners/2014-2019/hahn/announcements/agreement-skopje-overcome-political-crisis_en (Accessed 1 August 2018)
- Hafez, M and Mullins, C. (2015).** “The radicalisation puzzle: a theoretical synthesis of empirical approaches to homegrown extremism”. *Studies in Conflict and Terrorism* 38: 958-975
- Hafez, M. (2016).** “**The Ties that Bind:** How Terrorists Exploit Family Bonds”. *CTC Sentinel,* vol. 9, no. 2: 15-18
- HM Government (Her Majesty’s Government). 2018.** *CONTEST: The United Kingdom’s Strategy for Countering Terrorism.* Crown Printing. Available at: https://assets.publishing.service.gov.uk/government/uploads/system/uploads/attachment_data/file/716907/140618_CCS207_CCS0218929798-1_CONTEST_3.0_WEB.pdf (Accessed 1 August 2018)
- Holmer, G. (2013).** “Countering Violent Extremism: A Peacebuilding Perspective”. *Special Report 336,* United States Institute of Peace. Available at: <https://www.usip.org/sites/default/files/SR336-Countering%20Violent%20Extremism-A%20Peacebuilding%20Perspective.pdf> (Accessed 1 August 2018)
- Ingram, H. (2016).** “An Analysis of the Islamic State’s Dabiq Magazine”. *Australian Journal of Political Science* 51: 458-477
- International Centre for Transitional Justice (2009).** *Transitional Justice in the Former Yugoslavia.* Available at: <https://www.ictj.org/sites/default/files/ICTJ-FormerYugoslavia-Justice-Facts-2009-English.pdf> (Accessed 1 June 2018)
- Jovanovska, S. and Gjorgeski, B. (2010).** “Radical Islam in Macedonia worries Western observers”. *EU Observer,* 8 July. Available at: <https://euobserver.com/news/30446> (Accessed: 1 August 2018)
- Karakatsanis, L. and Herzog, M. (2016).** “Radicalisation as form: beyond the security paradigm”. *Journal of Contemporary European Studies* 24: 199-206
- Krzalovski, A. (2013).** *Доверба во луѓето и во институциите.* Macedonian Centre for International Cooperation. Available at: <http://www.m-prospect.com/wp-content/uploads/2013/10/doverba-vo-lugeto-i-vo-instituciite-2013.pdf> (Accessed 1 August 2018)

- Macedonian Centre for International Cooperation (2016).** Доверба во црквите и верските заедници. Macedonian Centre for International Cooperation. Available at: <http://mcms.org.mk/images/stories/Docs/Doverba-vo-GO-2008-tret-del.pdf> (Accessed 1 August 2018)
- Makedonija.name (2018).** Municipality of Cair. Available at <http://makedonija.name/municipalities/cair>. (Accessed 24 August 2018)
- Mahood, S. and Rane, H. (2017).** “Islamist narratives in ISIS recruitment propaganda”. *The Journal of International Communication* 23: 15-35
- Milanovic-Fazliu, A. (2015).** “Where are Macedonia’s Peacebuilders?” Building Peace Forum – Alliance for Peacebuilding. Available at: <http://buildingpeaceforum.com/2015/04/where-are-macedonias-peacebuilders/> (Accessed 1 August 2018)
- Mojsovska-Blazevski, N. and Ristovska, M. (2013).** European Training Foundation. Mapping of VET educational policies and practices for social inclusion and social cohesion in the Western Balkans, Turkey, and Israel – Country Report: Former Yugoslav Republic of Macedonia. Available at: [http://www.etf.europa.eu/eventsmgmt.nsf/\(getAttachment\)/E76C8CAoFA497939C1257C74004DDoDB/\\$File/The%20former%20Yugoslav%20Republic%20of%20Macedonia%20-%20FINAL%20Report.pdf](http://www.etf.europa.eu/eventsmgmt.nsf/(getAttachment)/E76C8CAoFA497939C1257C74004DDoDB/$File/The%20former%20Yugoslav%20Republic%20of%20Macedonia%20-%20FINAL%20Report.pdf) (Accessed 12 June 2018)
- Pearson, B. (2002).** “Putting Peace into Practice: Can Macedonia’s New Government Meet the Challenge?” Special Report 96, United States Institute of Peace. Available at: <https://www.usip.org/sites/default/files/sr96.pdf> (Accessed 1 August 2018)
- Popovska, B. and Ristoska, Z. (2015).** “Process of Reconciliation in a Postconflict Macedonia”. *Academicus International Scientific Journal*, vol. 11, no. 1. Available at: <http://www.academicus.edu.al/nr11/Academicus-MMXV-11-063-076.pdf> (Accessed 01 June 2018)
- Qehaja, F. and Perteshi, S. (2018).** The Unexplored Nexus: Issues of Radicalisation and Violent Extremism in Macedonia. Kosovar Centre for Security Studies. Available at : http://www.qkss.org/repository/docs/Extremism_in_macedonia_402663.pdf (Accessed 05 June 2018)
- Reka, B., ed. (2011).** Ten Years from the Ohrid Framework Agreement: Is Macedonia Functioning as a Multi-Ethnic State? Tetovo: South East European University. https://www.seeu.edu.mk/files/research/projects/OFA_EN_Final.pdf (Accessed 24 August 2018)
- Republic of Macedonia – State Statistical Office (2002).** www.stat.gov.mk (Accessed 05 June 2018)
- Ruge, M. (2017).** “Testimony of Dr Majda Ruge to the ‘Southeast Europe: Strengthening Democracy and Countering Malign Foreign Influence’ Hearing, 14 June 2017”. United State Senate Committee on Foreign Relations, Subcommittee on Europe and Regional Security Cooperation. Available at: https://www.foreign.senate.gov/imo/media/doc/061417_Ruge_Testimony_REVISED_II.pdf (Accessed 12 June 2018)
- Schmid, A. (2014).** Violent and Non-Violent Extremism: Two Sides of the Same Coin? The Hague: International Centre for Counter-Terrorism. Available at: <https://www.icct.nl/download/file/ICCT-Schmid-Radicalisation-De-Radicalisation-Counter-Radicalisation-March-2013.pdf> (Accessed 1 August 2018)
- Shabani, S. and Kadri, A. (2018).** “Working Towards Resilient Communities.” Analytica Think Tank. Available at: https://www.analyticamk.org/images/2018/CVE-EN-FINAL-WEB_272e4.pdf (Accessed 17 June 2018)
- Stojanović-Gajić, S. (2018).** “CSF Policy Brief No. 05: Security Issues in the Western Balkans”. Western Balkan Series, Civil Society Forum. Available at: <http://wb-csf.eu/wp-content/uploads/2018/05/CSF-PB-05-Security-Issues-in-the-Western-Balkans.pdf> (Accessed: 15 June 2018)
- Stojkovski, F. and Kalajdziovski, N. (2018).** Extremism Research Forum – Macedonia Report. Western Balkans Extremism Research Forum, British Council. Available at: https://www.britishcouncil.mk/sites/default/files/erf_macedonia_report_2018.pdf (Accessed 1 August 2018)
- Stojkovski, F. and Selimi, K. (2016).** Assessment of Macedonia’s Efforts in Countering Violent Extremism, View from Civil Society. Analytica Think Tank. Available at: https://www.analyticamk.org/images/Files/extremism-en-updated-FINAL-web_ceb98.pdf (Accessed 17 June 2018)
- United States Agency for International Development (USAID),** United States Government (2009). Guide to the Drivers of Violent Extremism. Available at: https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pnadt978.pdf (Accessed 02 June 2018)
- United States Agency for International Development (USAID),** United States Government (2011). The Development Response to Violent Extremism and Insurgency. Available at: https://pdf.usaid.gov/pdf_docs/Pdacs400.pdf (Accessed 02 June 2018)

World Population Review (2018). Population of Cities in Macedonia. Available at <http://worldpopulationreview.com/countries/macedonia-population/cities/>. (Accessed 24 August 2018)

Intervistat dhe grupet e fokusit

Çair

Përfaqësues anonim (Zyra e Kryetarit të Çairit). Intervistë nga: Macedonia Country Team (shkurt 2018)

Përfaqësues anonim (OJQ). Intervistë nga: Macedonia Country Team (shkurt 2018)

Përfaqësues anonim (OJQ). Intervistë nga: Macedonia Country Team (shkurt 2018)

Mësues anonim (Çair). Intervistë nga: Macedonia Country Team (shkurt 2018)

Mësues anonim (Shkollë e Mesme). Intervistë nga: Macedonia Country Team (shkurt 2018)

Fokus Grupi, 18-25 – Çair. Intervistë nga: Macedonia Country Team (shkurt 2018)

Fokus Grupi, 25-45 – Çair. Interview by: Intervistë nga: Macedonia Country Team (shkurt 2018)

Fokus Grupi, Femra – Çair. Intervistë nga: Macedonia Country Team (shkurt 2018)

Imam (Shkup). Intervistë nga: Macedonia Country Team (shkurt 2018)

Gostivar

Përfaqësues anonim (Zyra e Kryetarit të Gostivarit). Intervistë nga: Macedonia Country Team (janar 2018)

Përfaqësues anonim (OJQ e paemërtuar). Intervistë nga: Macedonia Country Team (janar 2018)

Mësues anonim (Shkollë e Mesme e Paemërtuar Gostivar). Intervistë nga: Macedonia Country Team (janar 2018)

Përfaqësues anonim (OJQ e Paemërtuar Gostivar – OJQ 2). Intervistë nga: Macedonia Country Team (janar 2018)

Përfaqësues anonim (OJQ e paemërtuar). Intervistë nga: Macedonia Country Team (janar 2018)

Salafi Ligjërues anonim – Gostivar. Intervistë nga: Macedonia Country Team (janar 2018)

Fokus Grupi, 18-25 – Gostivar. Intervistë nga: Macedonia Country Team (janar 2018)

Fokus Grup, 25-45 – Gostivar. Intervistë nga: Macedonia Country Team (janar 2018)

Fokus Grup, Femra – Gostivar. Intervistë nga: Macedonia Country Team (janar 2018)

Imam (Gostivar). Intervistë nga: Macedonia Country Team (janar 2018)

Struga

Përfaqësues i OJQ 1. Intervistë nga: Macedonia Country Team (mars 2018)

Përfaqësues i OJQ 2. Intervistë nga: Macedonia Country Team (mars 2018)

Imam anonim – Strugë. Intervistë nga: Macedonia Country Team (mars 2018)

Përfaqësues i mediave anonim – Strugë. Intervistë nga: Macedonia Country Team (mars 2018)

Psikolog anonim (Shkollë Filllore në Strugë e Paemërtuar). Intervistë nga: Macedonia Country Team (mars 2018)

Përfaqësues anonim (OJQ 1). Intervistë nga: Macedonia Country Team (mars 2018)

Përfaqësues anonim (Zyra e Kryetarit të Strugës). Intervistë nga: Macedonia Country Team (mars 2018)

Mësues anonim (Shkolla e Mesme e Paemërtuar). Intervistë nga: Macedonia Country Team (mars 2018)

Fokus Grupi, 18-25 – Strugë. Intervistë nga: Macedonia Country Team (mars 2018)

Fokus Grupi, 25-45 – Strugë. Intervistë nga: Macedonia Country Team (mars 2018)

Fokus Grupi, Femra – Strugë. Intervistë nga: Macedonia Country Team (mars 2018)

Kordinatori i Komunës – Strugë. Intervistë nga: Macedonia Country Team (mars 2018)